

Universiteti i Europës Juglindore
Универзитет на Југоисточна Европа
South East European University

Fakulteti Juridik
Правен факултет
Law Faculty



STUDIMET PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

**“Marëdhëniet bilaterale mes Republikës së Maqedonisë dhe
Republikës së Kosovës”**

Kandidati:

Samir Ganija

Mentori:

Prof.Dr.Bekim Nuhija

Tetovë, 2019

➤ **Kapitulli I**

1. REPUBLIKA E MAQEDONISË SI SUBJEKT NË MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

1.1 Pavarsimi i Republikës së Maqedonisë.....	7-8
1.2 Deklarata e pavarisës, organizimi i referendumit dhe miratimi i kushtetutës.....	9-12
1.3 Njohja e pavarisës dhe subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Maqedonisë.....	13-14
1.4 Antarsimi i Republikës së Maqedonisë në organizatat ndërkombëtare.....	14-15
1.5 Kontesti me Republikën e Greqisë reth çështjes së emrit	15-17
1.6 Marrëveshja e përkoshme mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë reth çështjes së emrit dhe njohja ndërkombëtare.....	17-20

➤ **Kapitulli II**

2. MARRËDHËNIET E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË ME FQINJËT DHE BASHKIMIN EVROPIAN PAS MARRËVESHJES SË OHRIT

2.1 Marrëveshja paqësore e Ohrit.....	21-25
2.2 Shkaqet që sollën deri te kjo marrëveshje.....	25-26
2.3 Marrëdhëniet e Republikës së Maqedonisë me shtet fqinje pas marrëveshjes së Ohrit.....	26
2.4 Marrëdhëniet e Republikës së Maqedonisë me Bashkimin Europian si dhe marja e statusit shtet kandidat pas marrëveshjes së Ohrit.....	26-27
2.5 Anëtarimi në NATO – samiti i Bukureshtit.....	27-28
2.6 Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.....	28-30
2.7 Hapja e perspektivës Euroatlantike dhe zgjidhja e kontesteve të hapura me Republikën e Bullgarisë dhe Greqisë.....	30-31

➤ **Kapitulli III**

3.ÇËSHITJA E KOSOVËS NË MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

3. Kontesti ndërkombëtar i shpalljes së pavarësisë së Kosovës.....	31-34
3.1 Rrethanat që sollën deri te shpallja e pavarësisë.....	34-35
3.2 Prania e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë dhe roli i tyre para dhe pas pavarësisë.....	38-38
3.3 Vendimi i Gjykatës ndërkombëtare të Drejtësisë për deklaratën e pavarësisë së Kosovës.....	38-40
3.4 Sfidat e Republikës së Kosovës drejt anëtarimit në Bashkimin Evropian.....	40-44
3.5 Strategjia për arritjen e njohjes së plotë ndërkombëtare të Republikës së Kosovës.....	44-48

➤ **Kapitulli IV**

4.NJOHJA E PAVARËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NGA ANA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË DHE ZHVILLIMI I MARRËDHËNIEVE BILATERALE

4.1 Historiku i marrëdhënieve Maqedoni –Kosovë.....	48-49
4.2 Njohja e pavarësisë së Republikës së Kosovës nga Republikës së Maqedonisë.....	49-50
4.3 Marrëdhëniet bilaterale Maqedoni – Kosovë.....	51-52
4.4 Marrëveshjet e nënshkuara, sfidat dhe ngeçjet në implemetntimin e tyre.....	52-70

➤ **Kapitulli V**

5.1 Konkluzionet.....	72
5.2 Referencat	73-74
5.3 Përfundimi.....	74-75
5.4 Bibliografia.....	76-79

Hyrje

Ky punim ka për qëllim të hulumtojë dhe të analizojë, të drejtën ndërkombëtare të një populli për pavarësi dhe krijimin e shtetit të tyre në këtë rast pavarësimin e dy shteteve Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës.

Siç është e njohur dy shtetet u formuan me shpërbërjen e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, duke i analizuar rethanat që sollën deri në pavarësimin e këtyre dy shteteve, sfidat me të cilat u ballafaquan dhe vazhdojnë të ballafaqohen në ndërtimin e tyre.

Republika e Maqedonisë në rugën e vetë drejt pavarësisë ose pas shpalljes së pavarësisë kaloi në një periudhë turbulente dhe shumë sfiduese. Pas shpalljes së pavarësisë, sfida e parë me të cilën u ballafaqua ishin marrëdhëniet ndëretnike, kryesisht ata kishin të bëjnë me statusin politik dhe juridik të shqipëtarëve, pastaj blokadata ekonomike nga ana e Republikës së Greqisë e cila vazhdoi për një kohë të gjatë duke kontestuar emrin e shtetit – gjë që rezultoi me nënshkrimin e marrëveshjes së përkoshme në vitin 1995. Si rezultat i kësaj marrëveshje kemi edhe njohjen ndërkombëtare dhe anëtarësimin në Kombet e Bashkuara si dhe organizata të tjera rajonale dhe ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë.

Republika e Maqedonisë si pasojë e paknaqësisë së popullatës shqipëtare u ballafaqua me konflikt të armatosur, i cili në fund rezultoi me nënshkrimin e marrëveshjes kornizë të Ohrit, marrëveshje e cila kishte për qëllim të avancojë statusin e popullatës shqipëtare.

Republika e Maqedonisë kaloi në një periudhë turbulente të karakterit politik gjatë viteve 2014-2016, e cila krizë u përmyll me nënshkrimin e marrëveshjes së Shkupit (Përzhinos). Më pas pasoi kriza e formimit të qeverisë dhe shumicës parlamentare të dalë nga zgjedhjet.

Sa i përket shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës rruga deri te pavarësimi ka qenë më e gjatë dhe më e dhimshme me pasoja në njerëz. Ideja për pavarësi të Republikës së Kosovës daton edhe para shpërbërjes së RSFJ, mirpo veprimet konkrete drejt pavarësimin u morën në fillimin e viteve të 90-ta, me shpalljen e Kushtetutës së Kaçanikut dhe me rezistencën paqësore të udhëhequr nga Ibrahim Rugova deri në vitin 1998, ku kemi edhe paraqitjen e rezistencës së armatosur.

Bashkësia ndërkombëtare mori si shembull luftën në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe masakrat e kryera nga ushtria dhe paramilitarët Serb, e cila ishte edhe arsyeja për marrjen e veprimeve ushtarake kundër Serbisë (rezultoi me largimin e pushtetit dhe forcave ushtarake dhe policore nga territori i Kosovës dhe erdhi deri te vendosja e forcave paqëruarës të udhëhequr nga NATO). Gjatë kësaj periudhe, kemi edhe vëndosjen e administratës së përkoshme të Kombeve të Bashkuara UNMIK, që kishte për detyrë të krijojë institucionet e reja dhe të vëndos paqën.

Kosova e shpalli pavarinë në 17 shkurt 2008. Shpallja e pavarisë pas dështimit të të gjitha bisedimeve me Sërbinë, rezultoi në angazhimin e bashkësisë ndërkombëtare duke angazhuar ish presidentin Finlandez Marti Ahtisari në pregaditjen e planit dhe kushteve që duhej të plotësoheshin për Kosovën, gjatë dhe pas shpalljes së pavarisë.

Kapitulli I:

1. REPUBLIKA E MAQEDONISË SI SUBJEKT NË MARDHËNIET NDËRKOMBËTARE

Hyrje

Përmbajtja tematike e këtij studimi ka për qëllim të analizojë periudhën që nga viti 1990 që çuan në krijimin e shtetit të pavarur të Republikës së Maqedonisë, në veçanti do të analizohet periudha e shpalljes së pavarësisë më 8 shtator 1991, dhe me nënshkrimin e Marrëveshjes së Përkohshme të 13 shtatorit të vitit 1995.

Gjatë kësaj periudhe në Republikën e Maqedonisë kanë ndodhur shumë ngjarje të cilat kanë kontribuar shumë në etablimin dhe funksionalizimin e Republikës së Maqedonisë si shtet i njohur ndërkombëtarisht.

Analizimi ngjarjeve në kontekstin juridik dhe politik ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë më të qartë të asaj se a ishte Republika e Maqedonia e pregaditur për ngjarjet që ndodhën në Evropën Lindore si dhe në ish-Jugosllavi ku erdhi deri të shpërbrja e shteteve të ish blokut komunist dhe sistemeve socialiste.

Në mënyrë kronologjike, do të trajtohen ngjarjet që ndodhën para dhe pas shpalljes së pavarësisë të cilat do të japin një pasqyrë të qartë për krijimin e shtetit të pavarur të Republikës së Maqedonisë, në veçanti organizimi i referendumit i mbajtur me 8 shtatorit të vitit 1991, miratimi i kushtetutës nga ana e Parlamentit të Republikës së Maqedonisë, njohja e pavarësisë dhe subjektivitetit, nënshkrimi i Marrëveshjes së Përkohshme të 13 shtatorit 1995, dhe anëtarësimi i Republikës së Maqedonisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

1.1 Pavarsimi i Republikës së Maqedonisë

Shpërbërja e RSFJ-së i dha Maqedonisë mundësinë që me referendumin e mbajtur më 8 shtator të vitit 1991 të shpall pavarësinë. Ndryshe nga republikat e tjera, Republika e Maqedonisë nga RSFJ doli pa konflikt ushtarak. Megjithatë, shpërbërja e RSFJ kishte reflektimin e vet mbi marrëdhëniet e Maqedonisë me fqinjët. Greqia e kundërshtonte flamurin, emrin duke akuzuar Maqedoninë për pretendime territoriale ndaj Greqisë. Bullgaria, nga ana tjetër, mohonte ekzistencën e popullit maqedonas, gjuhën dhe kombin, ndërsa Serbia kontestoi autoqefalinë e Kishës Ortodokse Maqedonase.¹

Hapat e parë drejt pavarësisë, Republika e Maqedonisë i ndërmori me 8 shtator 1991, me organizimin e referendumin ku popullata u deklarua për pavarësinë e shtetit nga ish federata Jugosllave. Popullata maqedonase për dallim nga popullata shqipëtare e Maqedonisë, u deklarua më shumë pozitivisht në pyetjen e referendimit “A janë për pavarësimin e Republikës së Maqedonisë me të drejtë për të hyrë në aleancë si shtet i pavarur me republikat e ish Jugosllavisë”.²

Më herët, me 25 janar 1991, parlamenti i parë shumëpartiak e miratoi deklaratën e pavarësisë, ndërsa vullnetin e shprehur në referendum, i njejtë parlament, formalisht e vërtetoi 10 ditë me vonë, duke miraturat Deklaratën me të cilin u pranua rezultati shprehur në referendum.

Republika e Maqedonisë ishte ndër të vetmet republika nga ish federata Jugosllave, e cila pavarësinë e vet e fitoi pa gjakëderdhje dhe pa luftë, duke pasur parasysh ngjarjet që pasuan në Slloveni, Koraci dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë. Mirpo pas shkatrimit të ish federatës Jugosllave dhe pavarësimin në mënyrë të qetë, pasoi një periudhë turbulente si në rafshin politik të brendshëm ashtu edhe në politikën e jashtme, në konsolidimin e një shtetit demokratik dhe ngritjen e institucioneve të shtetit të pavarur.

Hapi tjetër në forcimin e shtetit ishte miratimi i Kushtetutës së re e cila u miratua me 17 nëntor 1991. Gjithashtu, kemi edhe vënien në funksion të monedhës së shtetit dhe pavarësimin fiscal. Me datë 26 prill 1992, u lëshua në qarkullim valuta e re “Denar”, dhe më pas u formua Armata e Republikës së Maqedonisë.³

Pavarësinë e Republikës së Maqedonisë e para e njohu Republika e Bullgarisë, e ndjekur nga Republika e Turqisë, Koroacisë, Federata Ruse, Bosnja dhe Hercegovina si dhe shtete tjera. Subjektiviteti ndërkombëtar iu konfirmua me 8 prill 1993, ku me aklamacion nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, me 181 votë pro u pranua si anëtare e barabartë në Kombet e Bashkuara, me referencë të

¹ Јанчева Љ., Последните децени со СФРЈ, Менора, Скопје, 2012, стр. 54.

² Андов С., На мој начин, Матица Македонска, Скопје 2003, стр.286.

42 Исто, стр. 317.

³ Велјановски Н., Македонија 1945-1991 државност и независност, Институт за национална историја, Скопје 2002, стр. 364.

³ Кљусев Н., Патот кон македонската независност, Матица Македонска, Скопје 2001, стр. 263

përkohëshme - Republika Ish Jugosllave e Maqedonisë, që erdhi si rezultat i kundërshtimit nga Republika e Greqisë, e cila e kontestonte emrin e shtetit.⁴

Që nga shpallja e pavarësisë Republika e Maqedonisë ka vendosur marrëdhënie diplomatike me 168 shtete, ndërsa me emrin kushtetues me 132 shtete përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Federatën Ruse dhe Kinën si anëtare të përherëshme të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Në rrugëtimin e Republikës së Maqedonisë drejt pavarësisë dhe njohjes së subjektivitetit ndërkombëtar ishte shumë i rëndësishëm edhe vendimi i Komisionit të udhëhëqur nga konstitucionalisti i njohur Robert Badinter, i cili komision ishte formuar në vitin 1991 nga Unioni Europian, që kishte për qëllim ofroje këshilla juridike për çështjet që kishin të bëjnë me shpërbërjen e Jugosllavisë. Detyra primare ishte të përcaktohej nëse republikat jugosllave i plotësonin kriteret e UE për njohje diplomatike. Një kriter i rëndësishëm për njohjen ishte ekzistenca e garancive kushtetuese për të drejtat e pakicave. Si i tillë, qëllimi i Komisionit ishte të përcaktohej shkalla në të cilën ishin të mbrojtura të drejtat e pakicave në secilën prej ish republikave jugosllave, si kusht për njohje ndërkombëtare.

Më 11 janar 1992, Komisioni deklaroi se Maqedonia dhe Sllovenia i përmbushin kushtet e nevojshme që të njihen si shtete të pavarura. Duke pasur parasysh së komisioni ishte një organ *ad hoc*, mendime dhe këshilla e tij nuk konsideroheshin të obligueshme. Edhe pse, konkluzionet për Maqedoninë ishin mjaft pozitive, për shkak të kontestit me emrin me Republikën e Greqisë, UE nuk e njohi Republikën e Maqedonisë si shtet që më vonë u praqit edhe si pengesë për anëtarimin e Republikës së Maqedonisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), dhe Këshillin e Evropës etj.⁵

Rrugët e Republikës së Maqedonisë për antarsim në organizatat ndërkombëtare do të hapen me nënshkrimin e *Interim Accord* me Republikën e Greqisë, pas së cilës pasoi edhe antarsimi në të gjitha organizatat ndërkombëtare, me reference e përkohëshme Ish – Republika Jugosllave e Maqedonisë.

⁴ Малески Д., Бебето од катран – Македонија во меѓународните односи (1991-1993), Култура, Скопје 2012, стр. 65-73. 120 Исто, стр. 74-75.

⁵ Тунтев А., Република Македонија – прва декада (1990-1999), Ми-Ан, Скопје 2005, стр. 20-21.

Конференцијата имала за цел да изнајде мирно решение за кризата во Југославија. За претседател и главен преговарач бил поставен лордот Питер Карингтон.

Арбитражната комисија била составена од истакнати европски правници претседател на комисијата бил избран Роберт Бадинтер – претседател на Уставниот суд на Франција како членови биле: Роман Херцог – претседател на Уставниот суд на Германија, Алдо Корасани – претседател на Уставниот суд на Италија, Ирин Петри – претседател на Арбитражниот суд на Белгија и Франциско Томас Валиенте – претседател на Уставниот суд на Шпанија. Комисијата добила за задача до 15 јануари 1992 година да ги оцени барањата на републиките за независност.

1.2 Deklarata e pavarësisë, organizimi i referendumit dhe miratimi i kushtetutës

Deklarata e për pavarësi si dhe vendimi për mbajtjen e referendumit janë dy dokumentet kryesore që hodhën themelet në pavarësimin e Republikës së Maqedonisë. Me këta dy vendime Maqedonia filloi të lëvizë drejt pavarësisë dhe drejt procesit të shkëputjes nga shteti paraprak. Të dy dokumentet janë miratuar në një ambient të tensionur politik, brenda kampit politik maqedonas si dhe në rrafshin ndëretnik mes dy grupeve më të mëdha etnike në Maqedoni si dhe nga frika e reagimit eventual të institucioneve të ish federatës Jugoslave.⁶

Tensionet politike kishin edhe një arsye tjetër që kishte të bënte edhe me vetë paqartësinë e dokumenteve që nuk ishin të qarta dhe specifike dhe paraqisnin një dozë të madhe të paqartësisë dhe josisurisë duke lënë hapësirë për interpretime të ndryshme.

Deklarata mbi pavarësinë e Republikës Socialiste të Maqedonisë është dokumenti i parë në të cilin ndër të tjera për herë të parë u theksua sovraniteti i Maqedonisë dhe mundësinë e krijimit të shtetit të pavarur.

Në Nenin 1 " Deklarata e shpreh sovranitetin e Republikës Socialiste të Maqedonisë në bazë të dispozitave kushtetuese mbi pavarësinë dhe integritetin territorial të shtetit të Maqedonisë, dhe të drejtën e vetvendosjes, përfshirë të drejtën për shkëputje." Me deklaratë gjithashtu ishte e paraparë se sistemi politik, ekonomik dhe juridik do të bazohen në Kushtetutën e RSM dhe ligjeve të saja ndërsa ligjet federale dhe Kushtetuta e Jugosllavisë do të aplikohet vetëm nëse nuk bien në kundërshtim me to.

Deklarata parashihte që Parlamenti të miratojë Kushtetutën e re me të cilën duhej të përcaktohej rendi shoqëror dhe simbolet e ardhshme të shtetit të Maqedonisë. Gjithashtu, Deklarata theksonte se Maqedonia do të vendoste në mënyrë të pavarur mbi marrëdhëniet e ardhshme me shtetet dhe popujt e tjerë të Jugosllavisë ndërsa Kushtetuta e RSM dhe ligjet e saja do të ishin bazë për vendimet dhe veprimet e autoriteteve kombëtare dhe organizatave si dhe autoriteteve federale në territorin e Maqedonisë.⁷

Deklarata për pavarësinë është një dokument shumë i rëndësishëm si nga pikëpamja historike dhe politike dhe paraqiste një dokument i cili hapi rrugën për një shtet sovran, të pavarur dhe demokratik.

Për dallim nga Deklarata për pavarësi e cila u miratua menjëherë pas konstituimit të parlamentit të parë shumëpartiak, në kushtet kur qeveria e re ende nuk ishte formuar, vendimin për mbajtjen e referendumit e mori qeveria e posa formuar që ishte një qeveri e ekspertëve ku si kryeministër u zgjodh Nikola Klusev,

⁶ Декларација за прогласување на независноста на Република Македонија број 08-3786 од 17.09.1991,

⁷ Георгиевски С и Додевски С, Документи за Република Македонија 1990-2005, Правен Факултет „Јустинијан Први“, Скопје 2008. Шкарик С, Македонија на сите континенти, Унион Трејд, Скопје 2000, стр. 541.

gjithashtu parlamenti e zgjodhi edhe presidentin e parë Kiro Gligorov. Vendimin për mbajtjen e referendumit u miratua nga Kuvendi më 06 gusht 1991.

Me vendimin për mbajtjen e referendumit në nenin 2 ishte paraparë që qytetarët të deklarohen në pyetjen se "A jeni për një shtet sovran dhe të pavarur të Republikës së Maqedonisë me të drejtë për të hyrë në aleancë me shtete sovraane të Jugosllavisë", të deklarohen me "Për" ose "Kundër".⁸

Neni 3 e përcaktonte datën e mbajtjes së referendumit të parapar me 8 shtator 1991, ndërsa me nenin 4 ishte paraparë se referendumi do të organizohej në bazë të ligjit për Organizimin dhe Mbajtjen e Referendumit, dhe në Nenin 5 parashihej se referendumin do ta organizonte Komisioni shtetëror.

Përgatitjet e para për mbajtjen e referendumit filluan me miratimin e Ligjit për Referendum, i cili u miratua më 23 gusht 1991 ndërsa Referendumi u mbajt më 8 shtator 1991, Në referendum të drejte vote kishin 1.495.807 qytetarëve, të drejtën për të votuar e shfrytëzuan 1,132,981 qytetarë, ose 75,75% nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar. Me votë "PRO" votuan 1.079.308 qytetarë ose 95, 26% ndërsa 39,639 qytetarë votuan me "KUNDËR". Pas organizimit dhe mbajtjes së referendumi, kuvendi me 17 shtator 1991 miratoi edhe një Deklaratë me rëndësi të veçantë që kishte të bëjë me politikën e jashtme dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Ky dokument shpalosi parimet sipas së cilave Maqedonia nga pozita e shtetit të pavarur do të udhëhiqej në politikën e saj të jashtme dhe njohjen e saj ndërkombëtare.⁹

Parlamenti miratoi Deklaratën me të cilën shpalli referendumin të suksesshëm dhe plotëfuqishëm. Në nenin 1 të Deklaratës së Kuvendit, u konstatua se qytetarët me shumicë shprehën vullnetin e tyre dhe votuan që Republika e Maqedonisë të shpallet shtet sovran dhe i pavarur me të drejtën për të hyrë në aleancë të ardhshme me shtetet tjera sovraane të Jugosllavisë. Neni 2 përcaktoi se Republika e Maqedonisë subjektivitetin e saj ndërkombëtar do ta bazojë në bazë të normave ndërkombëtare mbi marrëdhëniet në mes shteteve të pavarura, në bazë të principeve të respektimit të integritetit territorial, mos-ndërhyrjes në çështjet e brendshme, respektimin e ndërsjelltë dhe bashkëpunimin e gjithanshëm. Neni 3 parashikoi përkushtimin në marrëdhëniet e mira me fqinjët si dhe me shtetet Evropiane dhe organizatat ndërkombëtare. Gjithashtu potencojë interesimi për kyçje në proceset integruese Evropiane si dhe pjesëmarrje në bashkëpunimet bilaterale dhe multilaterale në regjion. Neni 4 konfirmoi politikën se nuk ka pretendime territoriale ndaj cilit do shtet fqinj, gjithashtu u potencua se me vendosmëri do tu kundërvihet kërcënimeve reth integritetit dhe sovranitetit të saj territorial. Maqedonia do të angazhohej për zgjidhjen e problemeve me mjete paqësore dhe me anë të bisedimeve. Në neni 5 ishte shprehur shqetësimi në lidhje

⁸ Георгиевски С. и Додевски С., Документи за Република Македонија 1990-2005, Правен Факултет „Јустинијан Први“, Скопје 2008, стр. 151-152.

⁹ Кљусев Н, Патот кон македонската независност, Матица Македонска, Скопје 2001, стр. 189-193.
Тунтев А, Република Македонија – прва декада (1990-1999), Ми-Ан, Скопје 2005, стр. 18 .

me pozitën e popullit maqedonas në vendet fqinje. Neni 6 theksonte përgjegjësinë e Maqedonisë si faktor i paqës dhe sigurisë në këto hapësira, me qëllim të ndërtimit të shtetit modern dhe demokratik.

Deklarata e pavarësisë së Republikës së Maqedonisë u miratua nga parlamenti i Republikës Socialiste të Maqedonisë me 25 janar 1991.

Në referendumin e mbajtur më 8 shtator 1991, qytetarët e Republikës së Maqedonisë, e shprehën vullnetin e tyre dhe dhanë votën e tyre për një shtet sovran dhe të pavarur me kushtetutë dhe me ligj, që juridikisht u rumbullaksua me miratimin e Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë më 17 nëntor 1991.

Me miratimin e kushtetutës së re u konfirmua dhe konstituimi i Maqedonisë si shtet sovran, demokratik dhe shtet ligjor, i cili u bazua në sovranitetin e popullit dhe qytetarëve të saj si dhe sundimin e ligjit, barazisë sociale ". Gjithashtu u parapa që ajo të jetë një kushtetutë moderne e një shteti modern evropian me një demokraci parlamentare të standardeve të larta për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë qytetarëve. Propozimi ishte bazuar në faktin se Maqedonia ishte një shtet sovran i popullit maqedonas dhe të gjithë qytetarëve që jetojnë në të.

Pushteti demokratik duhej të bazohej në vullnetin e popullit si bashkësi e qytetarëve të lirë dhe të barabartë, e shprehur nëpërmjet zgjedhjeve të drejtpërdrejta dhe të lira në kushtet e pluralizmit politik. Kushtetuta duhej të ofronte promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave kolektive të të gjitha pakicave kombëtare dhe grupeve etnike (duke pasur parasysh faktin se Maqedonia ishte një shoqëri multikulturore në të cilën mbrojtja e të drejtave kolektive të pakicave).

Organizimi i pushtetit shtetëror ishte organizuar në bazë të parimit të ndarjes së pushteteve edhe atë legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Ky parim kishte për qëllim të sigurojë kontroll demokratik, barazpeshë dhe mënyrë efektive të plotësimit të ndarjes së pushtetit, ushtrimit të lirive të njeriut si dhe mbrojtjen nga monopolizimi i pushtetit. Gjithashtu ishte paraparë edhe promovimi i lirive dhe mbrojtja e barabartë e të gjitha llojeve të pronave në sferën ekonomike të shoqërisë.

Gjatë miratimit të kushtetutës, përfaqësuesit e subjekteve politike shqiptare e Parlamentin e Republikës së Maqedonisë, kundërshtuan miratimin e një kushtetute ku popullata shqipëtare nuk figuron si element konstituiv, përdorimin i gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare, arsimit etj, gjë që kishte hasur në kundërshtim të plotë nga faktori politik maqedonas, e cila më pas rezultoi edhe në mos votimin e kushtetutës dhe kontestimin e saj nga deputetët shqipëtar.

Edhe përkundër kundërshtimit nga deputetët shqipëtar, parlamenti i Maqedonisë me 92 vota pro e miratoi kushtetutën e re.

Sipas Kushtetutës, sistemi socio-ekonomik dhe politik i vendit ishte i bazuar në sundimin e ligjit, të drejtave dhe lirive të njeriut, ndarjes së pushtetit, ekonomisë së tregut dhe vlerave të tjera themelore të një shoqërie moderne demokratike. Në bazë të kushtetutës, Republika e Maqedonisë ishte shtet sovran, i

pavarur, demokratik dhe social. Sovraniteti i Republikës së Maqedonisë ishte i pandashëm, i patjetërsueshëm dhe jo i transferueshëm.

Në Republikën e Maqedonisë, sovraniteti lind nga qytetarët dhe i takon qytetarëve. Qytetarët e Republikës së Maqedonisë ushtrojnë pushtetin e tyre nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet referendumit dhe formave të tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë ¹⁰.

Kushtetuta si akt më i lartë juridik në vend ka pësuar 32 ndryshime (amendamente): 1992 (amendamentet 1 dhe 2), 1998 (amendamenti 3), 2001 (amendamentet 4-18), 2003 (amendamenti 19) 2005 (amendamenti 20-30), 2009 (amendamenti 31) dhe 2011 (amendamenti 32). Kushtetuta përbëhet nga Preambulla dhe nenet. Nenet e Kushtetutës janë të ndarë në disa kapituj: Dispozitat e përgjithshme, të drejtat dhe liritë e njeriut dhe qytetarit, organizimi i pushtetit shtetëror, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, Pushtetit Lokal, Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Mbrojtja e Republikës, gjendja ushtarake dhe emergjente, ndryshimi i Kushtetutës si dhe Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Neni 8 paragrafi 1 i Kushtetutës përcaktonte vlerat themelore të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë. Vlerat themelore të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë janë:

- Liritë dhe të drejtat themelore të individit dhe qytetarit të njohura në të drejtën ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutë;
- shprehja e lirë e përkatësisë kombëtare;
- përfaqësim adekuat dhe i barabartë i qytetarëve që i përkasin të gjitha komuniteteve në organet e pushtetit shtetëror dhe institucionet e tjera publike në të gjitha nivelet;
- sundimi i ligjit;
- ndarja e pushtetit shtetëror në legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor;
- pluralizmi politik dhe zgjedhjet e lira të drejtpërdrejta dhe demokratike;
- mbrojtja ligjore e pronës;
- liria e tregut dhe sipërmarrjes;
- humanizmi, drejtësia sociale dhe solidariteti;
- vetëqeverisja lokale;
- rregullimi dhe humanizimi i hapësirës dhe mbrojtja dhe promovimi i mjedisit dhe natyrës dhe
- respektimi i normave përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare.

¹⁰ Тунтев А, Република Македонија – прва декада (1990-1999), Ми-Ан, Скопје 2005, стр. 72-74.

1.3 Njohja e pavarisë dhe subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Maqedonisë

Pas miratimit nga Parlamenti i Republikës së Maqedonisë të Deklaratës për Pavarasi dhe Sovranitet, u miratua edhe Deklaratën për njohjen ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë si shtet Sovran dhe i pavarur.¹¹

Me këtë deklaratë kërkohet njohja ndërkombëtare e Republikës së Maqedonisë, në të njejtën kohë potencohet se i pranon dhe i ka plotësuar kriteret e mirautuara nga Këshilli i ministrave të Bashkimit e Evropian me 17 dhjetor 1991, gjithashtu pranon draftin e dokumentint nga konferenca e Hagës për Jugosllavinë, njëherit potencon përkrahjen për vazhdimin e konferencës për Jugosllavinë në Hagë, si dhe konfirmon pjesëmarrjen e saj në mënyrë konstruktive gjatë punës së saj, me qëllim të arritjes së një zgjidhje përfundimtare në mënyrë paqësore dhe demokratike.

Pas miratimit të Deklaratës nga kuvendi, Ministri i punëve të jashtme i kohës, Denko Malevski, më 20 dhjetor 1991, u dërgon letër Ministrit të Punëve të Jashtme të Hollandës, Hans van den Broek, kryetar i Komunitetit Evropian për të njohur Maqedoninë, me kërkesë për njohjen e pavarisë së Republikës së Maqedonisë.¹²

Me anë të kësaj letre infromon se kuvendi ka miratuar një Deklaratë për njohjen ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë si shtet i pavarur dhe sovran, si dhe mbështet vazhdimin e konferencës mbi Jugosllavinë si dhe obligohet të ofrojë garacione politike dhe kushtetuese për plotësimin e të gjitha kushteve dhe obligimeve.

Më heret, me 23 gusht 1991, Ministria e Punëve të Jashtëme, kishte pregaditur një memorandum, mbi pozicionin ndërkombëtar të Republikës së Maqedonisë, ky memorandum u ishte drejtuar shteteve antare të Bashkimit Evropian, për ti njoftuar më detajisht mbi qëndrimet e Maqedonisë në lidhje me zgjidhjen paqësore të krizës në Jugosllavi. Në këtë Memorandum, Republika e Maqedonisë angazhohej për zgjidhe paqësore, në ambient demokratik, ku republikave do të ju jepej mundësia për zgjidhje se a janë për një shtet të përbashkët apo shpërbërje në mënyrë paqësore.

Për zgjidhjen e krizës në Jugosllavi, Bashkimi Evropian, me 27 gusht 1991, në Bruksel miratoi Deklaratën për organizimin e një konference ndërkombëtare dhe themelimin/vendosjen e një procedure arbitrazhi në lidhje me situatën në Jugosllavi. Konferenca kishte për qëllim zgjidhjen paqësore të krizës në Jugosllavi ndërsa si negociator dhe kryesues ishte zgjedhur Lord Piter Karington. Me 7 shtator 1991, nisi punimet Konferenca për Jugosllavinë dhe u formua komision arbitrazhi i cili kishte për qëllim ti vlerësojë kërkesat për njohjen e pavarisë të një pjese të republikave Jugosllave.¹³

¹¹ Декларација за меѓународно признавање на Република Македонија како суверена и независна држава број 08-5099 од 15.12.1991.

¹² Андов С, На мој начин, Матица Македонска, Скопје 2003, стр. 346.

Георгиевски С. и Додевски С., Документи за Република Македонија 1990-2005, Правен Факултет „Јустинијан Први“, Скопје 2008, стр. 298.

¹³ Малески Д, Бебето од катран – Македонија во меѓународните односи (1991-1993), Култура, Скопје 2012, стр. 204.

Komisioni i arbitrazhit kishte për obligim deri më 15 Janar 1992, ti vlerësojë kërkesat e republikave për pavarësi, ndërsa ishte e përbërë nga Juristë eminent nga Evropa, nërsa për kryetarë ishte zgjedhur z.Robert Badinter – Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Francës. Antarë ishin Roman Hercog – Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë, Aldo Korasani - Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Italisë, Irin Petri – Kryetar i Gjykatës së Arbitrazhit të Belgjikës si dhe Francisko Tomas Valiente - Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Spanjës.

Me 11 janar 1992 Komisioni i arbitrazhit vlerësoi së të gjitha kushtet për njohje ndërkombëtare i plotësojnë Republika e Maqedonisë dhe e Slovenisë, si dhe i plotësojnë kriteret e miratuara nga Bashkimi Evropian, duke hequr dorë nga të gjitha pretendimet territoriale si dhe duke u përmbajtur nga çdo lloj propagande armiqësore kundër cilit do shtet. Njëkohësisht, përdorimi i emrit “Maqedoni” nuk duhet të nëkuptohen si pretendim territorial ndaj ndonjë shtetit tjetër. Në konferencën e Lisabonës, Bashkimi Evropian njohu pavarësinë e Sllovenisë dhe të Kroacisë ndërsa Republika e Maqedonisë nuk ishte pranuar pas kundërshtimit të Republikës së Greqisë.

Vendimi i Komisionit të Arbitrazhit u hapi rrugën të gjitha shteteve tjera që ta njohin dhe të vendosin marrëdhënie diplomatike me Republikën e Maqedonisë. Shteti i parë që njohu pavarësinë e Republikës së Maqedonisë ishte Republika e Bullgarisë, me 15 janar 1992, pasur nga Republika e Turqisë, e cila e njohu pavarësinë me 6 shkurt 1992, me 12 shkurt 1992 u njohën pavarësitë mes Maqedonisë, Sllovenisë dhe Kroacisë, me 20 prill 1992 Maqedoninë e njohti edhe Bosna dhe Hercegovina. Me 5 gusht 1992 u njohu nga ana e Federatës Ruse, edhe atë me emrin kushteues.

Numri më i madh i njohjeve të pavarësisë së Republikës së Maqedonisë ka ndodhur gjatë vitit 1993.

1.4 Antarsimi i Republikës së Maqedonisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB)

Republika e Maqedonisë u antarësua në Organizatën e Kombeve të Bashkuara me 8 prill të vitit 1993, me Rezolutën e Asamblesë së përgjithëshme të OKB-së A/RES/47/225. Anëtarësimi ishte bazuar në bazë të principeve dhe postulateve nga Karta e OKB-së.¹⁴

Republika e Maqedonisë hapat e para drejt antarsimit në Organizatën e Kombeve të Bashkuara i bëri me 7 prill 1993, në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ku edhe u miratua rezoluta 817, ku i propozohej Asamblesë së përgjithëshme të pranohet Republikenë e Maqedonisë si antare e Kombeve të Bashkuara, ku në pikën e dytë të rezolutës i propozohej Asamblesë së përgjithëshme, shteti i cili duhej të antarsohet, në kërkesën me S/25147, të pranohet si antare nën referencën e përkoshme “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” deri në tejkalimin e dallimeve që u praqitën rreth çështjes së emrit. Pjesë përbërse e rezolutës është edhe deklarata e presidentit të Këshillin e sigurimit e dhënë me datë 7

¹⁴ Љ.Д.Фрчкоски, В.Тупроски, В.Ортакоски, Меѓународно јавно право, Табернакул, 1995, стр.254.

prill 1993, në të cilën sqrohet referenca e përkohëshme nuk do të kishte asnjë llojë implikimi që në çfarë do llojë mënyre do e ndërlihte Republikën e Maqedonisë me Republikën Federale të Jugosllavisë.¹⁵

Asambleja e përgjithëshme e Kombeve të Bashkuara, në mbledhjen plenare të mbajtur me 8 prill 1993 e pranoi Republikën e Maqedonisë si antëtarja e 181 e Kombeve të Bashkuara. Republika e Maqedonisë u anëtarësua në Kombet e Bashkuara jo me emrin e saj kushtetues, por me një referencë të përkohëshme që erdhi si pasojë e kundërshtimit të Greqisë. Me anëtarësimin Republikës së Maqedonisë në Kombet e Bashkuara, u rrumbullaksua edhe subjektiviteti i saj ndërkombëtar

1.5 Kontesti me Republikën e Greqisë reth çështjes së emrit

Kontesti për emrin ndërmjet Republikës së Greqisë dhe Republikës së Maqedonisë kryesisht kishte të bëjë me çështjet lidhur me emrin e Maqedonisë, prejardhjen etnike të popullatës që jeton në këtë vend dhe përdorimin e gjuhës. Shkallëzimi i mosmarrëveshjes shtrihet në një kornizë të tillë që zgjidhja e saj do të kërkojë edhe pjesëmarrjen e ndërmjetësve ndërkombëtarë.

Kontesti në përgjithësi është rezultat i mosmarrëveshjes së Republikës së Greqisë për të pranuar emrin kushtetues të Maqedonisë. Zgjidhjen e përkohshme "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" (versioni anglisht i "ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë"), përveç Greqisë, e përdorin disa vende të tjera që nuk e njohin emrin kushtetues të Maqedonisë. Megjithatë të gjithë anëtarët e Kombeve të Bashkuara dhe OKB-së si tërësi, janë pajtuar të pranojnë zgjidhje që del si rezultat i bisedimeve dypalëshe në mes dy vendeve.¹⁶

Republika e Greqisë edhe para pavarësisë së Republikës së Maqedonisë nga Federata Jugosllave, edhe gjatë konferencës së Hagës si dhe në Komisionin e Badenterit, kishte një qajse që ishte kundër pavarësisë së Republikës së Maqedonisë më emrin në të cilin do të përmendet termi Maqedoni, duke insistuar që shteti i ri kishte pretendime territoriale nga shkak se termi Maqedoni përfshinte edhe teritore që gjendeshin jashtë kufijëve aktual të Republikës së Maqedonisë, përfshi pjesë edhe të teritorit Grek.

Edhe pas dhënies së garancive dmth me ndryshimin e Kushtetutës dhe të Flamurit (të Verginës), Republika e Greqisë insistonte që shteti të kishte një emër që nuk do të figuronte termi Maqedoni.

Republika e Greqisë hapat e para të kundërshtimit të pavarësisë së Republikës së Maqedonisë I ndërmorri që me 17 dhjetor 1991, në takim të ministrave të Bashkimit Evropian, ku edhe u miratua Deklarata për kriteriumet për njohjen e shteteve të reja nga Evropa lindore dhe ish Bashkimi Sovjetik. Në deklaratë thuhet se Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare kërkojnë nga secila Republikë e Jugosllavisë, para njohjes së pavarësisë së tyre, të obligohen të ofrojnë garanca të forta kushtetuese dhe politike se nuk kanë pretendime territoriale ndaj asnjë shteti fqinj, anëtar të Bashkimit Evropian. Pjesa e fundit e Deklaratës

¹⁵ Георгиевски С. и Додевски С., Документи за Република Македонија 1990-2005, Правен Факултет „Јустинијан Први“, Скопје 2008, стр. 540-541

¹⁶ Љ.Д.Фрчкоски, В.Тупрковски, В.Ортаковски Межународно Јавно Право, Табернакул, 1995, стр.293-294

kryekëput ka të bëjë me Republikën e Maqedonisë, e cila ishte inkorporuar me insistimin e Republikës së Greqisë. Edhe pse Republika e Maqedonisë i ofroi garancat e nevojshme i ndryshoi nenet 3 dhe 49 të kushtetutës edhe përkundër mendimit pozitiv nga komisioni i Badenterit, pavarësinë ua njohi Kroacisë dhe Sllovenisë.¹⁷

Inicijativë për zgjidhjen e kontestit mes Republikës së Maqedonisë dhe Greqisë kishte në vitin 1992, nga Portugalia, si kryesuese me Bashkimin Evropian, e cila kishte propozuar disa zgjidhje. Ndër propozimet ishte edhe propozimi “Republika Sllave e Maqedonisë dhe Republika e Re Maqedonase Shkup” edhe ky propozim ishte kundërshtuar nga Republika e Greqisë, në takimin e jashtëzakonshëm të ministrave të mbajtur në Gimaresh në maj 1992, pas kundërshtimit të Republikës së Greqisë u prolongua njohja e Republikës së Maqedonisë, nga shkak se në emrin e shtetit përmendet termi Maqedoni. Gjatë kësaj periudhe si zgjidhje që ishte pranuar ka qenë emri "Republika e Shkupit". Në deklaratën e ministrave pas takimit për herë të parë përmendet edhe termi "ish Republika Jugosllave e Maqedonisë".

Tentim tjetër për zgjidhje të kontestit me emrin kishte edhe gjatë udhëhqesjes me Bashkimin Evropian nga Britania e Madhe. Gjatë kësaj periudhe ishin propozuar disa zgjidhje edhe atë "Maqedonia Sllave", "Maqedonia e Vardarit" gjithashtu ishte propozuar edhe formula e dyfishtë për përdorim të brendshëm Republika e Maqedonisë për përdorim të jashtëm të gjendet një emer i pranueshëm për Greqinë edhe ky propozim ishte refuzuar nga Greqia por gjithashtu edhe nga Maqedonia. Ndërmejtësuesi Britanik, ambasadori Martin O Nil, në samitin e mbajtur në Edinburg, kishte pregaditur propozim që do të diskutohej në samit - "Republika e Maqedonisë (Shkup)". Ky propozim ishte shqyrtuar nga qeveria dhe njëherit ka pasur mendime që i njëjti të pranohet, por prap është refuzuar nga pala Greke.

Pas samitit të Edinburgut, duke pasur parasysh se kjo çështje nuk do mund të gjente zgjidhje të shpejtë, çështja në lidhje me njohjen e pavarësisë së Maqedonisë u bart në Kombet e Bashkuara, vendim që ishte përkrahur edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilët do të përkrahnin çfarë do lloj zgjidhje që do të arinin të dy shtetet.

Për gjetjen e një zgjidhjeje në lidhje me kontestin për emrin e shtetit, Sekretari Gjeneral i Kombeve të Bashkuara, në bazë të rezolutës 817 pika 3, caktoi dy ndërmejtësues Sajrus Vens dhe Lord Oven, të cilët kishin për obligim ti afrojnë qëndrimet e palëve për një zgjidhje reth pranimin të Maqedonisë në OKB. Ndërmjetësuesit e OKB-së si fillimin kishin pregaditur një Marveshje Miqësore në mes të Shkupit dhe Athinës, marveshje që kishte të bëjë me kufijtë actual, masat për ndërtimin e besimit, miqësisë dhe mardhënie të mira ndër fqinjësore. Propozim marrëveshja ishte propozuar të nënshkruhet nga "Maqedonia sllave", "Republika e Greqisë dhe Republika e Re e Maqedonisë". Greqia e kishte refuzuar marrëveshjen si tërësi nga shkak se përdoret termi Maqedoni ndërsa për Republikën e Maqedonisë i pa pranuesh ishte

¹⁷ Георгиевски С. и Додевски С., Документи за Република Македонија 1990-2005, Правен Факултет „Јустинијан Први“, Скопје 2008, стр. 450-468.

vetëm neni 5, nga gjithësej 25, që kishte të bëjë me emrin, që si alternativë ishte propozuar emri "Sllavomaqedonia"

Tentimi i radhës për gjetjen e një zgjidhjeje të kontestit për emrin e shtetit të Maqedonisë, vinte nga Gjermania nga Ministri i Punëve të Jashtme, Klaus Kinkel, I ashtuquajturit Plani i Kalus KInkelit, i cili në vete përmbante 6 pika: Republika e Greqisë ti tërheq të gjitha masat ndaj Maqedonisë, Maqedonia të heqë dorë nga simbolet Greke, të arriht marrëveshje për një emër të pajtueshëm edhe atë "Maqedonia e Re" ose "Maqedonia Veriore" , të arrihet marrëveshje tregëtare në mes BE dhe Maqedonisë , të nënshkruhet marrëveshje miqësie mes Maqedonisë dhe Greqisë, si dhe të sigurohet antarsimi i Maqedonisë në OSBE. Në nëntor të vitit 1994, kemi kyçjen më aktive të SHBA-ve, të cilët shqyrtojnë mundësinë e formulës së trefishtë për zgjidhjen e çështjes së emrit mes Shkupit dhe Athinës. Si ndërmjetësues caktohet Riçard Hollbruk, ndihmësi i Sekretarit të shtetit, ku edhe kishte përshpejtim të bisedimeve në kontestitn mes Maqedonisë dhe Greqisë. Inicijativa e parë për takim në mes Ministrave për punë ta jashtme të Greqisë dhe të Maqedonisë u mbajtë në Nju Jork me 13 shtator 1995, ku edhe erdhi deri të nënshkrimi i Marrëveshjes së përkohshme për normalizimin e marrëdhënieve në mes dy shteteve.

Kjo marrëveshje do ti hapë rrugë Maqedonisë për njohje ndërkombëtare dhe antarsim në Organizatat ndërkombëtare me referencën e përkohshme Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë deri në një zgjidhje të përhershme.

1.6 Marrëveshja e përkohshme mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë rreth çështjes së emrit.

Marrëveshja e përkohshme (*Interim Accord*) u nënshkrua më 13 shtator 1993 në Nju Jork, në përputhje me rezolutën 845 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara edhe kishte për qëllim normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë. Kjo marrëveshje u nënshkrua me ndërmjetësimin e Riçard Hollbruk, ish ndihmës i Sekretarit të shtetit në administratën e presidentit të SHBA, Bill Clinton. Në këtë dokument nuk përmenden shtetet si palë në marrëveshje.¹⁸

Palët nënshkruese duke iu referuar parimit të pacenueshmërisë së kufijve dhe integritetit territorial të shteteve të përfshira në Aktin Final të Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, nënshkruar në Helsinki, marrë parasysh rregullat e Kartës së Kombeve të Bashkuara, dhe në mënyrë të veçantë detyrimet e shteteve në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare të përmbahen nga kërcënimi apo përdorimi i forcës kundër integritetit territorial ose pavarësisë politike të cilit do shteti, të udhëhequr nga fryma dhe parimet e demokracisë dhe lirive themelore dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe të dinjitetit, në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe Aktin Final të Helsinkit, Kartës së Parisit për një

¹⁸ Георгиевски С. и Додевски С., Документи за Република Македонија 1990-2005, Правен Факултет „Јустинијан Први“, Скопје 2008, стр. 452-466.

Evropë të Re dhe aktet përkatëse të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, duke marrë parasysh interesin e përbashkët për ruajtjen e paqës dhe të sigurisë veçanërisht në rajonin e tyre, me dëshirën për të konfirmuar kufijtë ekzistues ndërmjet tyre si një kufi të përhershëm ndërkombëtar, duke u thirrur në obligimet e tyre në mos ndërhyrje në punët e brendshme të tjetrit, pa asnjë pretekst dhe në asnjë formë, me dëshirë që të zhvillojnë marrëdhëniet e tyre të ndërsjellta dhe të krijojnë një bazë të fortë për një klimë të marrëdhënieve dhe mirëkuptimit paqësor, me mirëkuptim se bashkëpunimi ekonomik është një element i rëndësishëm për zhvillimin e marrëdhënieve të ndërsjellta në një bazë të qëndrueshme dhe të fortë, si dhe dëshirë për zhvillim dhe promovim të bashkëpunimit në të ardhmen, me dëshirën për të arritur një marrëveshje të përkohshme, rënë dakord për:

Kjo marrëveshje në vete përmban 4 kapituj edhe atë:

- A. Marrëdhënie miqësore dhe masa për ndërtim të besimit;
- B. Të drejtat e njeriut dhe kulturore;
- C. Institucionet ndërkombëtare multilaterale dhe rajonale;
- D. Marrëdhëniet kontraktuale;
- E. Marrëdhëniet, ekonomike, tregëtare, ekologjike dhe juridike;
- F. Dispozitat përfundimtare.

Kapitulli A

Në këtë kapitull është e përmbledhur njohja reciproke si dhe vëndosja e marrëdhënieve diplomatike, me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje, Pala e parë (Republika e Greqisë) do të njohë pavarsinë e Palës së dytë (Republika e Maqedonisë) nën referencën e përkohëshme dhe vëndosjen e marrëdhënieve diplomatike me të vetmin qëllim vëndosjen e marrëdhënies në nivel të ambasadorëve, konfirmon kufirin aktual mes dy vendeve si ndërkombëtar - të përhershëm dhe të pacënueshëm, merren obligime për respektimin e sovranitetit dhe integritetit territorial të shteteve ku edhe asnjëra nga palët nuk do të përkrah asnjëlloj aktiviteti kundër integritetit territorial ndaj palës tjetër. Gjithashtu bazuar në Kartën e Kombeve të Bashkuara, do të përmbahen nga kërcnimet ose përdorimi i forcës me qëllim të shkeljes së kufive aktual.

Në bazë të kësaj marrëveshjeje palët pajtohen për vazhdimin e negociatave nën patronazhin e Sekretarit Gjeneral të Kombeve të Bashkuara, bazar në rezolutën 845 dhe 817 (1993) të Këshillit të Sigurimit, me qëllim të arritjes së një marrëveshjeje të përhershme.

Element tjetër i përfshirë në Marrëveshjen e përkohëshme është edhe obligimi dhe deklarimi publik i Republikës së Maqedonisë se Neni 3 dhe 49 i Kushtetutës nuk duhet të trajtohet si ndërhyrje ose

pretendim teritorial ose ndërhyrje në punët e brenëdshme të palës tjetër. Palët kanë marrë për sipër edhe ndërprerjen e përhapjes së propagandës armiqësore ndaj palës tjetër dhe gjithashtu se nuk do të pengohet lëvizja e lirë e qyteterëve dhe e mallrave në territoret e shteteve përkatëse.¹⁹

Kapitulli B

Në këtë kapitull është e përmbledhur repsktimi i të drejtave të njeriut dhe të drejtave kulturore, udhëhequr nga principet e demokracisë, liritë themelore, respektimin e të drejtave të njeriut dhe dinjitetit, në bazë të Kartës së Kombeve të Bashkuara, Deklaratës Univerzale për të drejtat e njeriut, Konventës Evropiane për mborjtjen e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore, Konventës ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha llojeve të diskriminimit racor, Konventës për të drejtat e fëmijëve etje.

Kapitulli C

Në këtë kapitull, Republika e Greqisë, pajtohet se nuk do të kundërshtojë antëarsimin e Republikës së Maqedonisë me referencën e përkohëshme (Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë) në organizatat multilaterale dhe rajonale, në të cilat Republika e Greqisë është anëtare dhe të përkrah zhvillimin ekonomik.

Kapitulli D

Marrëdhëniet kontraktuale, mes dy vendeve janë të regulluara në atë mënyrë që palët nënshkruese janë pajtuar që Republika e Maqedonisë në raportet me Republikës së Greqisë të shfrytëzojë marrëveshjet bilaterale të nënshkrara mes Republikës së Greqisë dhe Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë edhe atë: Konventa në lidhje aktet e ndërsjella juridike; Marrëveshja në lidhje me njohjen reciproke të vendimeve gjyqësore dhe zbatimin e tyre; Marrëveshja për në lidhje me menaxhimin me ujrat.

Kapitulli E

Obligohen palët nënshkruese që të përkrahin zhvillimin ekonomik, tregëtinë në mes bizneseve dhe kompanive të mëdha dhe të mesme, të thellojnë bashkëpunimin me institucionet hulumtuese si dhe kujdes të veçantë do ti përkushtojnë ambientit etj.

Kapitulli F

¹⁹ Ligji mbi ratifikimin e marrëveshjes së përkohëshme në mes Republikës së Greqisë dhe Republikës së Maqedonisë, nënshkruar më 13 shtator 1995 në Nju Jork nr 08-3396/1 nga 09.10.1995
://mfa.gov.mk/images/stories/Dokumenti/Vremena-sogodba-1995.pdf

Dispozitat përfundimtare, të kësaj marrëveshje kryesisht përqëndrohen në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve eventuale me theks të veçantë në mënyren paqesore ku i orienton palët në rast të shkeljes eventuale të drejtohen Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Kjo marrëveshje e përkohëshme do jetë në fuqi deri sa të zëvendësohet me një marrëveshje tjetër të përhershme.

KAPITULLI II

2. MARRËDHËNIET E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, FQINJËVE DHE BASHKIMIN EVROPIAN PAS MARRËVESHJES SË OHRIT

2.1 Marrëveshja paqësore e Ohrit

Marrëveshja e Ohrit u nënshkrujt me 13 gusht 2001, në gjuhën angleze nga kryetari i Republikës së Maqedonisë, Boris Trajkovski, lideri i VMRO-DPMNE-së dhe kryeministër Lubço Georgievski, liderët e LSDM-së Branko Cërvenkovski, të PPD-së Imer Imeri dhe PDSH-së Arbën Xhaferi. Gjithastu u nënshkruajt edhe nga ndërmjetësuesit ndërkombëtarë në dialog – Fransoa Leotar dhe Xhejms Perdj. Qëllimi i kësaj marrëveshje të paqës ishte promovimi i një shoqërie paqësore dhe harmonike, si edhe zhvillimi i një shoqërie qytetare ku respektimi i identitetit etnik dhe mbrojtja e interesave të të gjithë qytetarëve do të jenë primare. Kjo marrëveshje ishte vetëm një bazë, kornizë mbi të cilën u bënë ndryshimet kushtetuese dhe reformat ligjore të cilat zbatimin e vet e gjejnë në fushën e decentralizimit, përfaqësimit të drejtë, procedurave votuese të veçanta parlamentare me të cilat mbrohen etnitë që nuk janë shumicë nga mbivotimi, në fushën e arsimit, përdorimin e gjuhës, simboleve, shprehjen e identitetit kulturor dhe etnik si edhe masat për zbatimin e këtyre ndryshimeve.

Parimet themelore të kësaj marrëveshje ishin 4: Tërësisht dhe pa kusht hidhet poshtë përdorimi i dhunës për realizimin e qëllimeve politike. Vetëm zgjidhjet paqësore politike mund ta garantojnë stabilitetin dhe ardhmërinë demokratike të Maqedonisë; Sovraniteti dhe integriteti territorial i Maqedonisë dhe karakteri unitar i shtetit janë të pashkelshëm dhe duhet të ruhen. Nuk ekzistojnë zgjidhje territoriale për çështjet etnike; Karakteri shumëetnik i shoqërisë maqedonase duhet të ruhet dhe të gjejë shprehjen e vet në jetën publike. Një shtet bashkëkohor demokratik, në rrjedhën natyrore të zhvillimit dhe krijimit të vet, duhet vazhdimisht të sigurojë Kushtetutën e tij që tërësisht t'i plotësojë nevojat e të gjithë qytetarëve të saj, në pajtim me standardet më të larta ndërkombëtare si dhe vet të zhvillohen vazhdimisht; Zhvillimi i pushtetit vendor është me rëndësi thelbësore për nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën demokratike dhe për përparimin e respektimit të identitetit të bashkësive.²⁰

Marrëveshja përmban tre anekse edhe atë aneksi A – amendamentet kushtetuese, aneksi B – ndryshimet në legjislacion, aneksi C – implementimi dhe masat e ndërtimit të besimit. Kjo marrëveshje kornizë do ta promovojë zhvillimin e qetë dhe harmonik të shoqërisë qytetare, duke respektuar njëkohësisht identitetin etnik dhe interesat e të gjithë qytetarëve të Maqedonisë. Kjo marrëveshje do të ofrojë një kornizë për

²⁰ Влада на Република Македонија -Секретаријат за спроведување на Охридски рамковен договор- Извештај по однос на состојбата за имплементација на сите политики што произлегуваат од Охридскиот рамковен договор – Скопје 2012

sigurimin e ardhmërisë dhe demokracisë në Maqedoni dhe mundësimin e zhvillimit të marrëdhënieve më të afërta dhe më të integruara ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bashkësisë Europiane.

1. Parimet themelore

1. Tërësisht dhe pa kusht hidhet poshtë përdorimi i dhunës për realizimin e qëllimeve politike. Vetëm zgjidhjet paqësore politike mund ta garantojnë stabilitetin dhe ardhmërinë demokratike të Maqedonisë.
2. Sovraniteti dhe integriteti territorial i Maqedonisë dhe karakteri unitar i shtetit janë të pashkelshëm dhe duhet të ruhen. Nuk ekzistojnë zgjidhje territoriale për çështjet etnike.
3. Karakteri shumetnik i shoqërisë maqedonase duhet të ruhet dhe të gjejë shprehjen e vet në jetën publike.
4. Një shtet bashkëkohor demokratik, në rrjedhën natyrore të zhvillimit dhe krijimit të vet, duhet vazhdimisht të sigurojë Kushtetutën e tij që tërësisht t'i plotësojë nevojat e të gjithë qytetarëve të saj, në pajtim me standardet më të larta ndërkombëtare si dhe vet të zhvillohen vazhdimisht.
5. Zhvillimi i pushtetit vendor është me rëndësi thelbësore për nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën demokratike dhe për përparimin e respektimit të identitetit të bashkësive.

2. Ndërprerja e armiqësive

1. Palët e theksojnë rëndësinë e angazhimeve të 5 korrikut 2001. Do të ketë ndërprerje të tërësishme të armiqësive, çarmatimin e tërësishëm vullnetar të grupeve të armatosura etnike shqiptare, dhe shpërndarjen e tyre të tërësishme vullnetare. Ata e pranojnë faktin se për marrjen e Vendimit nga ana e NATO-s që të ndihmojë në këtë kontekst do të nevojitet vendosja e ndërprerjes së përgjithshme, pa kushte dhe të pakufizuar të zjarrit, pëlqimin për zgjidhjen politike të problemeve të këtij vendi, angazhimin e qartë të grupeve të armatosura që vullnetarisht të çarmatosen, dhe pranimin e të gjitha palëve kontraktuese për kushtet dhe kufizimet, në kuadër të të cilëve do të veprojnë forcat e NATO-s.

3. Zhvillimi i pushtetit të decentralizuar

1. Do të miratohet Ligji i reviduar i pushtetit lokal, me të cilin do të forcohen autorizimet e përfaqësuesve të zgjedhur vendor dhe dukshëm do të rriten kompetencat e tyre në pajtim me Kushtetutën dhe Kartën evropiane të pushtetit lokal, me ç'rast do të shprehet parimi i organizimit vertikal, i cili momentalisht është në fuqi në Bashkimin Evropian. Kompetencat e shtuara, para së gjithash kanë të bëjnë me sferat e shërbimeve publike, urbanistike dhe planifikimin rural, me mbrojtjen e ambientit të jetesës, zhvillimin ekonomik lokal, kulturën, financat lokale, arsimimin, mbrojtjen sociale dhe shëndetësore. Do të miratohet Ligji për financimin e pushtetit vendor me qëllim që të sigurohet sistemi përkatës i financimit, për t'iu mundësuar autoriteteve vendore t'i plotësojnë të gjitha kompetencat e tyre.

2. Brenda një viti pas përfundimit të regjistrimit të ri, i cili nën mbikqyrjen ndërkombëtare do të zbatohet deri në mbarim të vitit 2001, do të revidohen kufijtë komunal. Revidimi i kufijve komunal do të zbatohet nga autoritetet lokale dhe nacionale, me pjesëmarrjen ndërkombëtare.
3. Me qëllim që të sigurohet se policia është e vetëdijshme dhe përgjegjëse për nevojat dhe interesat e popullatës lokale, kryeshefat lokal të policisë do t'i zgjedhin këshilltarët e komunave nga lista e kandidatëve, të propozuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe të njëjtit rregullisht do të komunikojnë me këshillat. Ministria e Punëve të Brendshme do ta mbajë autorizimin për shkarkimin e kryeshefave lokal të policisë në pajtim me ligjin.

4. Mosdiskriminimi dhe përfaqësimi i drejtë

1. Tërësisht do të respektohet parimi i mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të të gjithë personave para ligjit. Ky parim do të aplikohet sidomos në raport me punësimet në administratën publike dhe në ndërmarrje publike, si dhe te qasja deri te financimi publik për zhvillimin e aktiviteteve afariste.
2. Në ligjet me të cilët rregullohen punësimet në administratën publike do të përmbahen masat me të cilat do të sigurohet përfaqësimi i drejtë i bashkësive në të gjitha organet qendrore dhe lokale publike dhe në të gjitha nivelet e punësimit në këto organe, duke respektuar njëkohësisht rregullat e kompetencës dhe integritetit, me të cilët udhëhiqet administrata publike. Autoritetet do të ndërmarrin aktivitet për ta korrigjuar mosekuilibrin ekzistues në përbërjen e administratës publike, sidomos përmes punësimit të pjesëtarëve të bashkësive me përfaqësim të pamjaftueshëm. Një vëmendje e posaçme do t'i kushtohet faktit që të sigurohet sa është e mundshme më shpejtë që shërbimet policore në përgjithësi ta shprehin përbërjen dhe shpërndarjen e popullatës së Maqedonisë, sikurse është theksuar në Aneksin C.
3. Për Gjykatën Kushtetuese 1/3 e gjykatësve do të zgjidhet nga kuvendi me shumicën e numrit të përgjithshëm të deputetëve që do të përmbajë shumicën e numrit të përgjithshëm të deputetëve të cilët pohojnë se i takojnë bashkësive që nuk janë popullatë shumicë në Maqedoni. Kjo procedurë do të aplikohet edhe gjatë zgjedhjes së Avokatit Popullor dhe tre anëtarëve të këshillit gjyqësor.

5. Procedurat e posaçme kuvendore

1. Në nivelin qendror, amendamentet kushtetuese dhe Ligji i Pushtetit Lokal, nuk do të mund të miratohen pa shumicën kualifikuese të 2/3 të votave, në kuadër të asaj që duhet të ketë shumicën e votave të deputetëve të cilët pohojnë se iu takojnë bashkësive të cilët nuk janë popullatë shumicë në Maqedoni.
2. Për nxjerrjen e ligjeve që drejtpërsëdrejti kanë të bëjnë me kulturën, përdorimin e gjuhës, arsimit, dokumenteve personale dhe përdorimit të simboleve, si dhe të ligjeve për financim lokal, zgjedhjet vendore, për qytetin e Shkupit dhe për kufijtë komunal do të duhet të ekzistojë shumica e votave në

kuadër të saj që duhet të ketë shumicën e votave të deputetëve të cilët pohojnë se iu takojnë bashkësive që nuk janë popullatë shumicë në Maqedoni.

6. Arsimimi dhe përdorimi i gjuhëve

1. Lidhur me shkollimin fillor dhe të mesëm, mësimi do të zhvillohet në gjuhën amtare të nxënësve, e njëkohësisht në mbarë Maqedoninë do të aplikohen standardet e unifikuara për programet akademike.
2. Financimi nga shteti do të sigurohet për arsimimin sipëror në gjuhët të cilën e flasin të paktën 20 për qind e popullatës në Maqedoni, e në bazë të marrëveshjeve të posaçme.
3. Gjatë regjistrimit në universitetet shtetërore të studentëve të rinjë të cilët iu takojnë bashkësive që nuk janë popullatë shumicë në Maqedoni do të aplikohet parimi i diskriminimit pozitiv, gjithnjë derisa regjistrimi nuk e shpreh si duhet përbërjen e popullatës në Maqedoni.
4. Në tërë Republikën e Maqedonisë dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase.
5. Cilado gjuhë tjetër të cilën e flasin të paktën 20 për qind e popullatës, poashtu është gjuhë zyrtare, sikurse është arsyetuar këtu. Në organet e Republikës së Maqedonisë, cilado gjuhë zyrtare tjetër nga maqedonishtja mund të përdoret në pajtim me ligjin, sikurse është elaboruar më tej në aneksin B. Cilido person që jeton në njësinë e pushtetit vendor në të cilin të paktën 20 për qind e popullatës flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga maqedonishtja mund të përdorë cilëndo gjuhë zyrtare për të komunikuar me zyren rajonale të pushtetit qendror, kompetent për këtë komunë; zyra e tillë do të përgjigjet në atë gjuhë në mënyrë plotësuese në maqedonishte. Cilido person mund ta përdor cilëndo gjuhë zyrtare për të komunikuar me zyren kryesore të pushtetit qendror, e cila do t'i përgjigjet në atë gjuhë, në mënyrë plotësuese në maqedonisht.
6. Lidhur me pushtetin vendor në komunat ku bashkësia e caktuar përbën të paktën 20 për qind e popullatës së komunës, gjuha e asaj bashkësie do të përdoret si gjuhë zyrtare, në mënyrë plotësuese maqedonishtja. Në raport me gjuhët, të cilët flasin të paktën 20 për qind të popullës së komunës autoritetit lokale në mënyrë demokratike do të vendosin për përdorimin e saj në organet publike.
7. Në procedurat penale dhe qytetare gjyqësore të cilitdo nivel, personi i akuzuar ose cilado palë do të ketë të drejtë të përkthimit në shpenzim të shtetit të të gjitha procedurave, si dhe të dokumenteve në pajtim me dokumentet përkatëse të Këshillit të Evropës.
8. Cilat do dokumente personale të qytetarëve që flasin gjuhën zyrtare ndryshe nga maqedonishtja poashtu do të lëshohen në atë gjuhë, në mënyrë plotësuese në gjuhën maqedonase në pajtim me ligjin.
7. Shprehja e identitetit
1. Lidhur me simbolet, pranë simbolit të Republikës së Maqedonisë, autoritetet vendore do ta kenë lirinë që në anën e parë të objekteve publike vendore të vendosin simbolet me të cilët shënohet identiteti i

bashkësisë e cila është në shumicë në komunë, me respektimin e rregullave dhe zbatimeve ndërkombëtare.

8. Implementimi

1. Amendamentet kushtetuese të propozuara në Aneksin A, menjëherë do të prezentohen para kuvendit. Palët do t'i ndërmarrin të gjitha masat për ta siguruar miratimin e këtyre amendamenteve në periudhën prej 45 ditë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje Kornizë.
2. Miratimi i ndryshimeve në legjislacion, të përcaktuara në Aneksin B, do të jenë në pajtim me dinamikën e theksuar atje.
3. Palët i bëjnë thirrje komunitetit ndërkombëtar, që sa më shpejt ta thirrin konferencën e donatorëve në të cilën sidomos do të bisedohet për ndihmën makrofinanciare; përkrahjen e financimit të masave që do të ndërmerren për nevojat e implementimit të kësaj marrëveshje kornizë, duke përfshirë edhe masat e forcimit të pushtetit vendor; dhe revitalizimin dhe ndërtimin e rajoneve të goditura nga luftimet.²¹

2.2 Shkaqet që sollën deri te kjo marrëveshje

Ndër arsytet themelore që sollën deri te konflikti i armatosur ishin se popullata shqiptare pas pavarimit të Republikës së Maqedonisë konsideronte vehten si qytetarë të rendit të dytë. Manifestimet e pakënaqësive vazhduan gjatë viteve 1990, ndërsa në vitin 1991 shqiptarët si fillim bojkotuan referendumin për pavarësinë si dhe regjistrimin e popullsisë, ndërsa në janar 1992 në shenjë paknaqësie nga pozita juridiko kushtetuese organizuan referendumin për autonominë territoriale. Paknaqësia e popullatës shqiptare në Maqedoni u shfaq edhe në vitin 1994 me kontestimin regjistrimit e popullsisë.

Paknaqësitë dhe revolta u rrit edhe në vitet në vijim, në vitin 1995, me rastin e hapjes së Universitetit të Tetovës, nga reagimet e qeverisë së Maqedonisë kundër këtij institucioni, përveç që u burgosën një numër i madh i bartësve të inicijativës për themelimin, nga aksioni policor në Tetovë përveç shumë të lënduarëve kishte edhe një viktimë. Paknaqësia do të vazhdojë edhe në vitet në vijim, në vitin 1997, reagimi i policisë në Tetovë dhe Gostivar, me rastin e vendosjes së flamurit kombëtar shqiptar para godinave të komunave, u arrestuan kryetarët e komunave të Tetovës dhe Gostivarit, ndërsa nga aksioni policor në Gostivar, përveç një numri të madh të të lënduarëve kishte edhe 4 viktima.

Kryesisht kërkesat e popullatës shqiptare në Republikën e Maqedonisë, kishin të bënin me ndryshimin e Kushtetutës, që do të mundësonte avansimin e pozitës juridiko kushtetuese, nga një popullatë e rendit të

²¹ http://www.siofa.gov.mk/data/file/Ramkoven_dogovor_al.pdf, http://www.siofa.gov.mk/data/file/ustav_ustavni_amandmani_al.pdf

dytë - në popullatë shtet formuese, që do tu lejonte më shumë hapsirë dhe të drejta në arsim, përfaqësim në institucionet shtetërore.²²

2.3 Marrëdhëniet e Republikës së Maqedonisë me shtet fqinje pas marrëveshjes së Ohrit

Marrëveshja kornizë e Ohrit Republikës së Maqedonisë përveç avansimit të të drejtave të popullatës shqipëtare edhe pakicave tjera siç janë pakica serbe, rome, vllehe, turke dhe boshnjake, njëkohësisht u ofroi mundësinë edhe pakicave tjera etnike të shprehin identitetin e tyre edhe pse nuk janë të njohura si kategori kushtetuese, në veçanti për ata që ndjehen si bullgar. Marrëveshja e Ohrit ndikoi edhe në relaksim të mëdha të raporeteve mes dy shteteve shqipëtare, atë të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, e cila gjatë kohës së nënshkrimit të marrëveshjes ende ishte nën administrimin e Kombeve të Bashkuara. Marrëveshja kornizë e Ohrit, këtyre dy vendeve u dha një sinjal se avancimi i të drejtave të shqipëtarëve dhe avancimi i statusit juridiko kushtetues do të mer formën e dëshiruar, do të këtë përfaqësim më të madh në institucionet dhe do të luaj një rol më të rëndësishëm në zhvillimet politike dhe në sigurinë që ishte edhe arsyeja kryesore në relaksim të raporeteve dhe bashkëpunimit bilateral në të gjitha sferat.

Raportet me Republikën e Serbisë nuk patën ndonjë ndryshim rënjësor duke pasurë parasysh se pakica serbe, ishte më shumë e përfshirë në jetën politike mirpo prap se prap u shfrytëzua si element edhe për avansimin edhe më të madh të të drejtave të tyre.

Marrëdhëniet me Republikën e Bullgarië dhe Republikën e Greqisë nuk patën ndonjë ndryshim të madh. Ato vazhduan të jenë në të njëjtin nivel siç edhe ishin edhe para marrëveshjes, mirpo kishin një kahje dhe natyrë tjetër (jan me Greqinë reth çështjes së emrit të shtetit ndërsa me Bullgarië reth identitetit kombëtar).

2.4 Marrëdhëniet e Republikës së Maqedonisë me Bashkimin Evropian si dhe marrja e statusit shtet kandidat pas marrëveshjes së Ohrit

Marrëveshja kornizë e Ohrit, Republikës së Maqedonisë i ofroi një stabilitet më të madh politik sidomos implemetimi i saj i dha një shtytje të madhe asaj drejt anëtarimit në Bashkimin Evropian. Si rezultat i implemtimit dhe zbatimit të marrëveshjes kornizë të Ohrit, Republika e Maqedonisë me Bashkimin Evropian nënshkroi marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim, që hyri në fuqi me 1 prill 2004, që erdhi si rezultat i zbatimit të marrëveshjes kornizë të Ohrit. Marrëveshja për Sabilizim dhe Asociim në vete

²² В.Габер Од объект до субјект, Македонија во меѓународните односи, Fridrich Ebert Stiftung, Скопје 2017стр.309 -2018

përmban 10 kapituj²³ të cilët përfshijnë një sërë reformash në shtetet si paraksuht për vazhdimin e rrugës drejt anëtarimit në Bashkimin Europian, që në mënyrë direkte ose indirekte kanë të bëjnë edhe me avancimin e pozitës së shqipëtarëve në institucionet e shtetit siç janë dialogu piolitik i brendshëm, bashkëpunimi rajonal, funksionimi i shtetit ligjor etj.²⁴

Falë implementimit dhe zbatimit të marrëveshjes së Ohrit, në veçanti ndryshimeve kushtetuese, Republika e Maqedonisë avansoi edhe më tej në rrugën drejt Bashkimit Europian, që si rezultat ishte edhe marrja e statusit e vendit kandidat në dhjetor të 2005, por nuk iu caktua data për hapjen e negociatave. Marrëveshja e Ohrit rol të rëndësishëm luajti edhe me rastin e liberalizimit të vizave për Republikën e Maqedonisë, 12 prill 2007 ku një ndër kriteret ishte edhe stabiliteti politik.

2.5 Anëtarimi në NATO – samiti i Bukureshtit viti 2008

Republika e Maqedonisë me 15 nëntor 1995, nënshkroi dokumentin për qasje në programin Partneriteti për Paqë. Bashkëpunimi u intensifikua me hapjen e zyrës ndërlidhëse me 14 qershor 1996, ndërsa në fund të vitit 1997 u hap edhe misioni i përhershëm i Maqedonisë në selinë e NATO në Bruksel.

Pas raundit të saj të zgjerimit, më 29 mars 2004, kur shtatë ish vendet e Evropës Lindore u bashkuan me organizatën, NATO pretendonte të mbante një "politikë të dyerve të hapura". Sidoqoftë, Aleanca dukej të mendonte rreth aftësisë së saj për të pranuar anëtarë të rinj dhe racionalitetin e një politike të vazhduar zgjerimi.

Për të maksimizuar mundësinë e pranimit në organizatë, në nëntor 2004, Maqedonia u bashkua në të ashtuquajturën Karta e Adriatikut së bashku me Shqipërinë dhe Kroacinë, dy kandidatë të tjerë të NATO-s, me qëllim të intensifikimit të përpjekjeve për aderim. Pavarësisht shqetësimeve se Kroacia mund të përpiqet të shkojë vetëm, bashkëpunimi midis tre vendeve ka avancuar pa probleme.²⁵

Republika e Maqedonisë në rrugën drejt plotësimit të standardeve ishte angazhuar në një varg misionesh ndërkombëtare paqeruajtëse - në Irak, Afganistan dhe Bosnje-Hercegovinë - dhe ofroi përkrahje logjistike për KFOR-in në Kosovë, me qëllim që të demonstronte angazhimin e saj ndaj organizatës.

Në Samitin e Rigës të 2006, shefat e shteteve dhe qeverive të NATO-s deklaruan se Aleanca kishte për qëllim të shtonte ftesat për vendet që përmbushin standardet e NATO-s për t'u bashkuar me Traktatin e Atlantikut të Veriut në Samitin e tij të vitit 2008. Maqedonia që të arinte antarsimin në NATO kishte shfaqur gadishmëri për antarsim edhe me emrin e ish-Republikës Jugosllave e Maqedonisë (IRJM), që

²³ Указ за прогласување на Законот за рафтификација на спогодбата за стабилизација и асоцијација меѓу Република Македонија и Европските заедници и нејзините членки 07-1432/1 од 12.04.2001 година.

²⁴ Т.Бендевски, Право на Европска Унија, УКИМ, Правен Факултер, Скопје 2001, стр 319-335.

²⁵ В.Габер Од објект до субјект, Македонија во мѓенуародните односи, Fridrich Ebert Stiftung, Skopje 2017, Str 318-320.

kishte qenë e detyruar të pranonte për t'u pranuar në Kombet e Bashkuara në prill 1993, pas refuzimit të Greqisë për të njohur emrin e saj kushtetues.

Në samitin e NATO në Çikago, të mbajtur në maj të 2012 u riafirmua ftesa për antarsim duke u thirur në marrëveshjen e Bukureshtit të mbajtur në prill 2008, ku ishte riafirmuar gadishmëria për të qenë antare e barabartë në NATO, me kushtë që ftesa të dërgohet menjëher pas arritjes së një marrëveshje të pranueshme me Greqinë reth çështjes së emrit.

Vlen të theksohet se Republika e Greqisë që nga koha e nënshkrimit të marrëveshjes së përkohshme në Nju Jork, nuk e kishte penguar Republikën e Maqedonisë në antarsimin e saj në organizatat ndërkombëtare me emrin e përkohshëm IJRM.

Kundërshtimi i Republikës së Greqisë kundrejt Republikës së Maqedonisë ishte si pasojë e provokimeve të njëpasnjëshme nga qeveria e kohës së Republikës së Maqedonisë, duke emruar objekte dhe autostrada me personalitete të kulturës dhe historisë antike greke (aeroporti dhe magjistrallja) si dhe shpalosja e hartës së Maqedonisë antike.

2.6 Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë

Aktgjykimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, 5 Dhjetor 2011

Gjykata vendosi se: kundërshtimi për pranimin e Republikës së Maqedonisë në NATO në periudhën para Samitit të NATO-s në Bukuresht në vitin 2008, Greqia kishte shkelur marrëveshjen e përkohshme të vitit 1995. Nga Greqia nuk pritet të shkelë përsëri ligjin ndërkombëtar (sipas përkufizimit, supozohet "besimit të mirë"). Maqedonia mund të vazhdojë të përdorë emrin e saj kushtetues në marrëdhëniet me Greqinë dhe brenda organizatave ndërkombëtare. Të gjitha pretendimet e Greqisë se Republika e Maqedonisë shkel marrëveshjen e Përkohshme janë refuzuar.

Historia

Që nga shpallja e pavarësisë së Republikës së Maqedonisë në vitin 1991, Greqia ka kundërshtuar vazhdimisht emrin e shtetit dhe anëtarësimin e saj në organizatat ndërkombëtare. Marrëveshja e përkohshme, e nënshkruar më 13 shtator 1995 nga Republika e Maqedonisë dhe Republika e Greqisë, është korniza kryesore juridike për normalizimin e marrëdhënieve dypalëshe. Neni 11 parashikon detyrim eksplicit për Greqinë që të mos kundërshtojë pranimin ose anëtarësimin e plotë të Republikës së Maqedonisë në organizatat ndërkombëtare nën emrin e përkohshëm "Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë", siç parashikohet në Rezolutën 817 e vitit 1993 të Këshillit të Sigurimit Kombet e Bashkuara.

Gjatë procesit të marrjes së ftesës për anëtarësim në NATO, Republika e Maqedonisë nuk e ka shkelur këtë dispozitë, duke rënë dakord për procedurën e anëtarësimit në NATO nën referencën përfshirë në paragrafin 2 të Rezolutës 817 (1993) së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Në prill të vitit 2008, në Samitin e NATO-s në Bukuresht, Greqia kundërshtoi pranimin e Republikës së Maqedonisë në NATO. Ajo gjithashtu kundërshtoi procesin e pranimit të Maqedonisë në BE. Më 17 nëntor 2008, Republika e Maqedonisë ka inicuar procedurë para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (ICJ), duke i kërkuar Gjykatës për të gjykuar se Greqia pengoi anëtarësim në NATO të Maqedonisë dhe me këtë ka shkelur marrëveshjen e përkohëshme në mes dy vendeve.

Aktgjykimi i Gjykatës së 5 dhjetorit 2011 është i detyrueshëm për Palët dhe nuk janë të lejuara mjete juridike kundër tij.

Vendimi I gjykatës ishte se i hodhi poshtë të gjitha pretendimet dhe argumentet e paraqitura nga Greqia gjatë procedurës:

Gjykata konstatoit se zgjidhja e kontestit ose dallimet rreth emrit nuk janë kompetencë e gjykatës por i gjithë procesi të zgjidhet në kuadër të Kombeve të Bashkuara, gjithashtu gjykata u shpall jo kompetente edhe reth veprimeve të shteteve anëtare të NATO-s, të cilët vendosën që Republikës së Maqedonisë ti refuzohet antarsimi. Gjithashtu gjykata vendosi që mos ndërmarë asnjë lloj vendimi në lidhje me kontestitin e emrit për arsye se mund të konsiderohej si ndërhyrje në negociatat të cilat zhvillohen në Kombet e Bashkuara për gjetjen e zgjidhjes rreth kontestit me emrin, në njëjtën kohë nëse do të kishte ndërhyrje atëherë shtetet anëtare të NATO-s Republikës së Maqedonisë do duhet ti drejtoheshin me emrin kushtetues, njëkohësiht në komunukimin me NATO-n Republikës së Maqedonisë nuk i lejohet të përdor emrin e saj kushtetues.

Gjykata duke marrë parasysh të gjitha argumentat e Republikës së Greqisë vendosi:

Çështje e vetme që nuk është kompetencë të gjykatës është të sjellë vendim rreth dallimeve për çështjen e emrit, ndërsa pPadia e Republikës së Maqedonisë kishte të bëjë me sjelljen e Greqisë që nuk bie në kompetencë të gjykatës, duke marrur parasysh se edhe gjatë vendosjes paralelisht zhvillohen bisedime për gjetjen e një zgjidhjeje rreth këtij kontesti.²⁶

Republika e Greqisë kishte kundërshtuar përdëromin e emrit kushtetues të Republikës së Maqedonisë në të gjitha fazat e bashkëpunimit me NATO-n, përfshi edhe komunikimin - adresimin kundrejt Republikës së Maqedonisë të jetë në Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë.

Gjykata i jep të drejtë Republikës së Maqedonisë të përdor emrin e saj kushtetues edhe në raportet me Greqinë edhe në suazat e organizatave ndërkombëtare, ku në mënyrë eksplicite kishte vendosur se Republika e Maqedonisë ka të drejtë të quhet si Republika e Maqedonisë në raportet me Greqinë si dhe Greqia nuk mund të kundërshtojë qasjen ose antarsimin e plotë në NATO ose në organizat tjera

²⁶Клучини елементи на Република Македонија против Грција пресуда ма Меѓународниот суд на правдата 5 декември 2011 година.

ndërkombëtare me të vetmin qëllim që Republika e Maqedonisë mund të emrohet në organizatat ndërkombëtare me emrin e saj kushtetues. Gjykata kishte hedhur poshtë të gjitha pretendimet e Republikës së Greqisë se Republika e Maqedonisë kishte shkelur marrëveshjen e përkoshme njherit kishte konstatuar se Republika e Maqedonisë merr pjesë në bisedimet reth çështjes së emrit me besimin e mirë si dhe e kishte ndaluar aktivitetet dhe propagandën armiqësore që rrjedhimisht edhe nuk ka bërë shkeljen e marrëveshjes Paragrafi 1 nga neni 7. Gjithashtu përdorimi i simboleve në bazë të nenit 7, paragrafi 3, ku ndalohet vetem përdorimi i emrit të saj kushtetues. Gjykata kishte konstatuar se Republika e Maqedonisë nuk e kishte shkelur marrëveshjen e përkohëshme me emrimin e Aeroportit, Petrovecnë Aleksandri i Madh. Edhe pse gjykata kishte konstatuar se Republika e Greqisë e kishte shkelur marrëveshjen e përkohëshme, mirëpo kishte refuzuar kërkesën e Republikës së Maqedonisë, që gjykata ta urdhërojë Republikën e Greqisë, që mos e pengojë në të ardhmen (paragrafi 168).

Vendimi i gjykatës nuk i ndërlidh shtetet e treta ose vetë NATO-n dhe Bashkimin Evropian. Gjykata kishte konstatuar se kundërshtimi nga ana e Greqisë para dhe pas samitit në Bukuresht, paraqet shkelje të të së drejtës ndërkombëtare, njëkohësisht kundërshtimi i Greqisë ka qenë e vetmja arsye pse Republika e Maqedonisë nuk u antarsua në NATO, në samitin e Bukureshtit nga shkaku se nuk u arrit konsensus. Konkluzionet e dalura nga ky samit i obligojnë palët që ti vazhdojnë bisedimet për gjetjen e një zgjidhje reth emrit të Maqedonisë, që do të jetë edhe kusht që Maqedonia të antarsohet në NATO vetem atëherë kur do të arrijë marrëveshje me Greqinë reth emrit.²⁷

2.6 Hapja e perspektivës Euroatlantike dhe zgjidhja e kontesteve të hapura me Republikën e Bullgarisë dhe Greqisë.

Integrimi Euroatlantik i Republikës së Maqedonisë është i lidhur ngushtë me implementimin e dy marrëveshjeve bilaterale të nënshkruara me dy shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe të NATO-s edhe atë; Marrëveshjes për miqësi, marrëdhënie të mira ndërfqinjësore dhe bashkëpunim me Republikën e Bullgarisë si dhe Zbatimi i Marrëveshjes me Republikën e Greqisë reth emrit kushtetues të Maqedonisë. Marrëveshja për miqësi, marrëdhënieve të mira ndërfqinjësore dhe bashkëpunimit me Republikën e Bullgarisë, është një marrëveshje e cila forcon marrëdhëniet mes Republikës së Bullgarisë dhe Republikës së Maqedonisë. Kjo marrëveshje ka për qëllim të forcojë bashkëpunimin bilateral dhe multilateral, respektin e ndërsjellë të interesave të dy popujve si dhe forcimin e sigurisë dhe stabilitetit në Evropën juglindore.²⁸ Kjo marrëveshje kontribon edhe në evitimin e dallimeve rreth gjuhës dhe kombit maqedonas nga ana e Republikës së Bullgarisë. Që nga shpallja e pavarësisë nga Republika e Maqedonisë, pengasat më të mëdhaja në rrugën drejt anëtarimit në organizatat ndërkombëtare, Republika e Maqedonisë e kishte nga

²⁷ <http://mfa.gov.mk/images/stories/Dokumenti/Summary-ICJ-MKD.pdf>

²⁸ http://mfa.gov.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=112&Itemid=391&lang=mk

fqiu jugor - Republika e Greqisë, edhe përkundër nënshkrimit të marrëveshjes së përkohëshme mes dy vendeve ku Greqia mer obligim se nuk do ta pengojë integrimin e Maqedonisë në organizatat ndërkombëtare me referencën e përkohëshme Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, në samitin e Bukureshtit në vitin 2008, ajo kundërshtoi antarsimin e Maqedonisë në NATO.

KAPITULLI III

3. ÇËSHTJA E KOSOVËS NË MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

3.1 Kontesti ndërkombëtar i shpalljes së pavarësisë së Kosovës

Rrëzimi i murit të Berlinit më 9 nëntor 1989 (që simbolizonte luftën e demokracisë kundër totalitarizmit), hapi një proces të ri politik në nivel ndërkombëtar. Zhvillimet të këtyra që ndodhën në vendet e Evropës Lindore, edhe në shumë vende të ish bllokut komunist njashtu edhe në Kosovë nga “Lëvizja Studentore” e vitit 1981, e cila u shndërruar në një Lëvizje për Republikën e Kosovës dhe më vonë edhe për pavarësi.

Fundi i vitit 1989 dhe fillimi i vitit 1990 shënoi fillimin e shpërbërjes së Federatës që do të jetë më tragjika për popujt që e përbënin atë, shpërbërja e Federatës Jugosllave kishte dëme dhe shkatërrime më të mëdha, si në planin njerëzor, ashtu edhe në rrafshin ekonomik.²⁹ Procesi i shpërbërjes juridike të Jugosllavisë fillimin e vet e kishte me fillimin luftërave dhe referendimet për pavarësi (dhjetor 1990 – shpalljet e pavarësive të Sllovenisë dhe të Kroacisë (25 qershor 1991), Bosnjë-Hercegovinës (1991), Maqedonisë (1991), çlirimit të Kosovës në qershorin e vitit 1999 dhe Referendumi i Malit të Zi (2006) për shpërbërje nga federata e mbetur – Serbia.³⁰

Në hapësirën e Federatës Jugosllave janë zhvilluar katër luftëra. Republika e Sllovenisë pati fat që ta përmbyllte më së lehti konfliktin e armatosur me Serbinë meqenëse Serbia nuk kishte pretendime tokësore ndaj saj. Ndërsa Kroacia, Bosnjë-Hercegovina dhe Kosova patën fatin e keq të zhvillojnë luftime më të ashpra me ushtrinë jugosllave, e cila e tëra komandohej nga Millosheviqi dhe klika kriminale e tij. Kosova deri më tani është shteti i fundit që u themelua nga shpërbërja e Federatës Jugosllave. Një fat më të mirë në këtë shpërbërje e patën dy republikat e vogla të Federatës Jugosllave, Maqedonia dhe Mali i Zi.³¹ Shpërbërja e Federatës Jugosllave filloi në Kongresin XIV të Jashtëzakonshëm të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, aty ku komunistët sllovenë, të mbështetur nga kroatët, nuk e pranuan diktatin nga politika e kohës në Beograd. Kjo shpërbërje pastaj u përcoll me katër luftëra në të cilat palë kryesore ishte Armata

²⁹ Shklyen Gashi Historia e Kosovës në tekstet mësimore të histories në Kosovë, Shqipëri, Mal të Zi dhe Maqedoni, alter habitus, instituti për studime në shoqëri dhe kulturë, Prishtinë 2016.

³⁰ Dr. Jakup Krasniqi: Pavarësi dhe personalitete, Buzuku, Prishtinë 2012, f. 22.

³¹ Dr. Jakup Krasniqi: Pavarësi dhe personalitete, Buzuku, Prishtinë 2012, f. 22.

Popullore Jugosllave, e cila u vu në mbrojtje të politikës serbe.³² Kësaj shpërbërjeje i ndihmuan edhe dy konferenca ndërkombëtare (e Dejtonit dhe ajo e Rambujesë) dhe bisedimet e Vjenës, të udhëhequra nga emisari special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, ish-presidenti i Finlandës, Marti Ahtisari.³³

Këto bisedime kishin si qëllim, gjetjen e statusit final për Kosovën. Shpërbërja e Federatës Jugosllave duhej të ishte shpëtim edhe për Serbinë, e cila i kishte edhe meritat më të mëdha për atë shpërbërje. Me fillimin e konfliktit të armatosur në Kosovë kemi edhe organizimin e Konferencës Ndërkombëtare të Rambujesë për Kosovën, e cila jo vetëm i hapi rrugën bombardimeve të NATO-s në Federatën Jugosllave (Serbi – Mal i Zi), por do të linte hapur mundësinë që pas tri vitesh të hapej rruga e Pavarësisë së Kosovës. Në kapitullin VIII të Dokumentit Politik të Rambujesë thuhej: “Tre vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje, një takim ndërkombëtar do të mbledhet për të përcaktuar një proces për të cilin do të bihet dakord, që të bëhet vendosja përfundimtare e statusit të Kosovës. Kjo do të bëhet në bazë të vullnetit të popullit të shprehur në një referendum, përpjekjeve të së cilës palë në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshje, dhe të Aktit final të Helsinkit. Takimi do të marrë një vlerësim të plotë të zbatimit të kësaj marrëveshjeje si dhe do të konsideroj propozimin e çdonjëres palë për masa shtesë”³⁴.

Pas përfundimit të Konferencës së Rambujesë dhe të nënshkrimit të njëanshëm të saj nga Delegacioni i Kosovës, me përfaqësuesit amerikanë e evropianë (BE), u hap rruga për bombardimet e NATO-s, të cilat filluan më 24 mars 1999. Këto bombardime sollën për Kosovën dhe qytetarët e saj më shumë se sa parashihej në Dokumentin Përfundimtar të Rambujesë, pasi më 21 qershor 1999 e gjithë makineria policore, ushtarake dhe administrata e dhunshme serbe, u larguan nga Kosova. Kosovës, pas bombardimeve të NATO-s, me Rezolutën 1244 iu caktua periudha e Administrimit Ndërkombëtar, e njohur si UNMIK, me kryeadministratorë ose ndryshe të dërguar special të Sekretarit Gjeneral të Kombeve të Bashkuara.³⁵

Para se të fillonin bisedimet, Grupi i Kontaktit, në të cilin merrte pjesë edhe Rusia, i caktuan parimet bazë mbi të cilat do të zhvilloheshin bisedimet. Deklarata i kishte tri parime kryesore: 1. Nuk ka kthim para marsit të vitit 1999; 2. Nuk do të ketë ndryshim të kufijve, dhe 3. Kosova nuk mund të bashkohej me asnjë shtet, që do të thotë, nuk mund t’i bashkohet as Serbisë e as Shqipërisë. Ndërsa teksti integral i këtij parafrazimi është në pikën e gjashtë të Deklaratës së Grupit të Kontaktit, ku thuhet: 6. “Zgjidhja e statusit të Kosovës duhet të konsolidojë sigurinë dhe stabilitetin rajonal. Në këtë mënyrë, kjo do të sigurojë që Kosova të mos kthehet në gjendjen e para marsit të vitit 1999. Çdo zgjidhje që është e njëanshme apo është rezultat i përdorimit të forcës nuk do të jetë e pranueshme. Nuk do të ketë ndryshime të territorit të

³² “Rilindja”, 22.1.1989, Prishtinë.

³³ M.Dikson dhe R.Mekorkuoel, Raste dhe Materijale nga e Drejta Ndërkombëtare, Shkup, 2010, Datapons, f.139-148.

³⁴ Dokumenti Përfundimtar i Rambujesë

³⁵ Marrëveshja për Demilitarizimin e UÇK-së mes Hashim Thaçit dhe Komandantit të KFOR-it, Gjeneral Xheksanit, 21 qershor 1999, në Aeroportin e Sllatinës.

tanishëm të Kosovës, që do të thotë nuk do të ketë ndarje të Kosovës dhe bashkim të Kosovës me ndonjë shtet tjetër apo me ndonjë pjesë të ndonjë shteti tjetër. Integriteti territorial dhe stabiliteti i brendshëm i fqinjëve rajonalë do të respektohet plotësisht.³⁶ Kjo deklaratë u hapi rrugë bisedimeve të Vjenës, mes Beogradit e Prishtinës, nën udhëheqjen e përfaqësuesit special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Marti Ahtisarit. Dokumenti përfundimtar ishte dokument i kompromisit, pra nuk ishte vullnet i imponuar i asnjë pale, e më së paku i palës shqiptare (të Kosovës).

I gjithë Dokumenti i Presidentit Ahtisari është ndërtuar në frymën e deklaratës së grupit të kontaktit. Pjesë e dokumentit ishte edhe Rusia, dhe pjesëmarrëse aktive në të gjitha fazat e bisedimeve të Vjenës. Edhe në bisedimet e Vjenës si në ato të Rambujesë pala ruse e serbe i shtynë kërkesat e tyre në dokumentet përfundimtare dhe në fund nuk i pranuan rezultatet e bisedimeve. A do të përsëritet e njëjta gjë në bisedimet e Brukselit do ta tregojë e ardhmja ketë.³⁷

Kornizat që i vendosi Grupi i Kontaktit për të dërguarin e Sekretarit të Përgjithshëm, Presidentin Finlandez Marti Ahtisari, ishin parapërgatitje si për propozimin që dha për Këshillin e Sigurimit për mbikëqyrjen e pavarësisë, ashtu edhe për pakon gjithëpërfshirëse të tij për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Raporti që Presidenti Ahtisari ia dërgoi Sekretarit të Përgjithshëm dhe këshillit të sigurimit, më 26 mars 2007, në vete ishste një propozim për statusin e ardhshëm të Kosovës dhe “Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës”. Pas gati dy vjet negociatash të drejtpërdrejta, bisedimesh dypalëshe dhe konsultimesh të ekspertëve dhe pasi u pa që palët nuk mund të merren vesh për statusin e ardhshëm të Kosovës, pasi palët këmbëngulnin në qëndrimet e tyre: pala serbe për një autonomi dhe pala kosovare asgjë më pak se pavarësi. Pra, ishte e qartë se palët nuk do të arrinin ndonjë marrëveshje as për çështje thjesht praktike, edhe pse, ç’është e vërteta, ka mundur të arrihet vetëm një progres fare modest. Kësisoj, Marti Ahtisari e shfrytëzoi mandatin e tij për të përcaktuar dinamikën si dhe kohëzgjatjen e bisedimeve, pasi ishte konsultuar edhe me Sekretarin e Përgjithshëm, gjithnjë duke e parë nivelin e bashkëpunimit mes palëve dhe situatën në vend, dhe pa mundësinë që palët me bisedime të arrinin te një marrëveshje e dakorduar.³⁸ Duke u nisur nga kjo, ai kishte ardhur në përfundimin se asnjë format shtesë i bisedimeve nuk mund t’i nxjerrë ato nga kjo rrugë, ndaj ishte i bindur se zgjidhja e kësaj çështjeje duhet të ishte urgjente, dhe kishte ardhur në përfundim kishte ardhur koha që të zgjidhej statusi i Kosovës. Propozimi fillestar kishte qenë pavarësi e mbikëqyrtur fillimisht nga bashkësia ndërkombëtare që përfundoi në vitin 2012.³⁹

³⁶ Parimet udhëheqëse të Grupit të kontaktit për zgjidhjen e statusit të Kosovës, 7 tetor 2005 (http://www.unosek.org/docref/2005-10-07_-_Kontakt_Group_-_Ten_Guiding_principles_for_Ahtissari_-_albanian.pdf).

³⁷ Marti Ahtisari: Propozimi për Presidentin e KS dhe Sekretarin e Përgjithshëm në OKB-së i 26 marsit 2007, dokumenti S/2007/168.

³⁸ Njëjtë pika 5

³⁹ Njëjtë pika 10

Pavrasimi i Kosovës hapi një kapitull të ri për rajonin e Evropës në përgjithsi, të cilit do t'i mundësojë më shumë “paqe, stabilitet dhe prosperitet për të gjithë”. Bisedimet që i udhëhoqi Marti Ahtisari, në mënyrë të pashmangshme çuan në propozimin e tij për Pavarësinë e mbikëqyrur të Kosovës, e cila u formalizua me shpalljen e saj, më 17 shkurt të vitit 2008, kur në Kuvendin e Kosovës u votua Deklarata e Pavarësisë nga 109 deputetë, përfshirë dhe Kryetarin e Kuvendit, të pasuar edhe nga Presidenti dhe Kryeministri i Kosovës. Deklarata e Pavarësisë e parashihte “Republikën e Kosovës shtet të pavarur, sovran dhe demokratik”.⁴⁰

3.2 Rethanat që sollën derit te shpallja e pavarësisë

Lufta që ndodhi në Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë, të cilat në ish-Jugosllavi kishin statusin e republikës, ndërsa e Kosovës me 28 mars 1989 iu ishte marrë autonomia, do të nisë një etapë e re e organizimit politik në Kosovë e cila do të pasojë me rezistenën paqësore të udhëhequr nga ish presidenti i Kosovës Dr. Ibrahim Rugova. Pas organizimit të rezistenës paqësore filloi edhe ngritja e intucioneve paralele në Kosovë, ku më 2 korik 1990, shpallet pavarësia ndërsa në shtator 1990 kemi edhe miratimin e kushtetutës si aktin më të lartë juridiko-kushtetues dhe një ndër angazhimet kryesore ishte krijimi i kontakteve me institucionet ndërkombëtare BE dhe NATO-n, por me interes të veçantë ishte edhe krijimi i raporteve të veçanta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që më vonë do të dëshmojnë si vendimtare në rrugën drejt çlirimit dhe të pavarësisë së Kosovës.

Me fillimin e konfliktit të armatosur në vitin 1998, Bashkimi Europian, NATO-ja si dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke u nisur nga përvoja me Bosnjën dhe Hercegovinën si dhe masakrat e ndodhura në Reçak dhe Drenicë, bashkësia ndërkombëtare me qëllim evitimin e pasojave edhe me të mëdha organizoi bisedimet në mes përfaqësuesve të Kosovës dhe Serbisë me qëllim ndalimin e dhunës dhe esaklimit të luftës në përmasa edhe më të mëdha, kështu me 6 shkurt 1999, filluan bisedimet në Rambuje, Francë. Në këta bisedime grupi i kontaktit, kishte ofruar një marrëveshje me të cilën kërkohej largimi i trupave serbe me qëllim hyrja e trupave paqëruajtëse, kjo marrëveshje ishte pranuar nga delegacioni kosovar kurse ishte refuzuar nga delegacioni serb. Me dështimin e bisedimeve të Rambujesë dmth me refuzimin e marrëveshjes të ofruar nga grupi i kontaktit, me 24 mars 1999 filuan sulmet ajrore të NATO-s kundër caqeve ushtrake serbe të cilët zgjatën deri më 6 qershor 1999, pas arritjes së marrëveshjes së Kumanovës, në mes të Serbisë dhe NATO-s që edhe mundësoi hyrjen në Kosovë të trupave të NATO-s. Në të njëjtën periudhë, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi rezolutën për Kosovën që ishte 1244, rezolutë e cila obligonte që në Kosovë të kishte një protektorat ndërkombëtar me një mision civil që do të ishte UNMIK-u dhe misionin ushtarak që do të ishte KFOR-i. Të dy këto misione

⁴⁰ Njëjtë pika 16

kishin për qëllim stabilitetin e vendit dhe njëkohësisht organizimin e organeve udhëheqese të Kosovës. Nevoja për një stabilitet politik dhe ekonomik më të qëndrueshëm dhe njëkohësisht për të dalë nga statuskuoja ku gjendeshte Kosova dhe për të gjetur një zgjidhje afatgjatë për statusin e Kosovës që do të ofrontë paqë, siguri dhe stabilitet në të gjithë rajonin.

Me ndërmjetësimin e ish presidentit Finlandez Marti Ahtisari, si përfaqësues i Sekretarit Gjeneral të Kombeve të Bashkuara filluan bisedimet për statusin final të Kosovës, mes Serbisë dhe Kosovës edhe në këta bisedime edhe pse zgjatën dy vjet, nuk u arrit marrëveshje mes dy palëve, gjë që rezultoi me pregaditjen e palnit për pavarësinë e Kosovës, që ishte pavarësi e mbykëqyrur, ky plan parashihte si do të formohej dhe si do të funksionalizohet pavarësia e Kosovës. Plani i Ahtisarit kishte kushtet e saj, me saktë ishin 44 ligje të cilat ishin si kusht për Pavarësi, të gjitha këto ligje në ta cilat parashihej të drejta shtesë për minoritetet, rruajtja e trashigimisë kulturore dhe fetare apo edhe kushtin tjetër që shteti i Kosovës duhet të jetë një shtet multietnik ku simbolet e Kosovës nuk do të përmbanin elemente të simboleve kombëtare, si dhe nuk mund ti ngjanin as një shteti tjetër. Me gjithë këto kushte pala kosovare e pranoi këtë propozim.

Kosova e shpalli pavarësinë e vetë me 17 shkurt 2008. Parlamenti i Kosoves u mbledh në një mbledhje të jashtëzakonshme ku përmes leximit të deklaratës së pavarësisë nga ish Kryeministri Hashim Thaqi dhe nënshkrimit të saj nga Presidenti Fatmir Sejdiu dhe deputetet shpalli Kosovën shtet të pavarur dhe demokratik.

3.3 Prania e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë dhe roli i tyre para dhe pas pavarësisë

Roli i OSBE-së në Kosovë, para pavarësisë

Kosova gjithnjë e më shumë bëhej agjendë europiane dhe ndërkombëtare si nevojë dhe qëllim në mbikëqyrjen e gjendjes, për të vëzhguar dhunën serbe që ushtroheshte mbi kosovarët. Ishte një domosdoshmëri prezenca e OSBE-së, për të faktuar se çka ishte duke ndodhur në Kosovë. Bashkimi Evropian për të qetësuar rajonin dhe konfliktin e posa filluar kërkoi që Këshilli i Sigurimit i OKB-së, më 23 Shtator 1998 të miratojë Rezolutën 1199, që detyronte armëpushim dhe ndërpreje të dhunës në territorin e Kosovës. Ky vendim i OKB-së, detyroi Misionin Verifikues për Kosovën, i udhëhequr nga OSBE, të dislokojë mbi 2 mijë vëzhgues në të gjithë Kosovën. Misioni i OSBE-së është njëri ndër misionet kryesore ndërkombëtare, i përfshirë në të gjithë proceset, për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Kosovë. Ky mision kishte për objekt të saj kryesor zhvillimet politike ndërtuese të sigurisë, demokracinë preventive, sigurimin e mjedisit, si një dëshmi e drejtpërdrejtë e ngjarjeve që zhvilloheshin në Kosovë. OSBE-ja punonte për stabilitet, mirëqenie dhe demokraci. Misioni i OSBE-së në

Kosovë ka qenë ndër operacionet më të mëdha në teren që është marrë ndonjëherë gjatë historisë së veprimit të OSBE-së.⁴¹

Roli i OSBE-së pas Pavarësisë

Që nga viti 1999, OSBE-ja ka qenë si shtyllë e tretë e UNMIK-ut, si përgjegjëse për ndërtimin e institucioneve demokratike dhe shumetnike në Kosovë. Misioni i OSBE-së në Kosovë si një element qëndror i UNMIK-ut të rikonfiguruar, që ky zvogëlim i UNMIK-ut pas largimit përfundimtar t'i jap hapësirë më të madhe OSBE-së dhe një rol më të madh edhe në të ardhmen. OSBE vazhdon të jetë aktive në ngritjen, përmirësimin e proceseve dhe në monitorimin sa me të drejtë të shumë sektorëve politikë brenda në Kosovë. OSBE-ja ka qenë neutrale ndaj Statusit përfundimtar të Kosovës. Me kalimin e kohës misioni ka ndryshuar rolin në mbikëqyrje të çështjeve të ndryshme në Kosovë. Roli i OSBE-së, pas Pavarësisë po adresohet më shumë në aspektet në këshillëdhënie dhe mbështetje për institucionet dhe politikën e Kosovës, sidomos në forcimin e demokracisë, e cila është e një rëndësie jetike për perspektiven e Kosovës. OSBE-ja edhe me tej do të jetë e nevojshme të luajë një rol bashkëpunimi me institucionet e Kosovës dhe ofrimin e ndihmës partive politike, sikurse edhe në vendet e tjera sovraane të rajonit që OSBE-ja është e përfshirë si mision i tillë⁴². Pozicionimi i OSBE-së, sa i përket bashkëpunimit në Kosovë, sot ka qasje ndihmesash të proceseve angazhuese e bashkëpunuese me EULEX-in, si dhe me organizata, misione europiane të ndryshme të nevojshëm për Kosovën. Pas Pavarësisë misioni i OSBE-së po kryen një numër aktivitetesh në Kosovë, shumë prej të cilave kanë ndihmuar për informimin lidhur me planifikimin e Misionit EULEX në Kosovë. Misioni i OSBE-së në Kosovë është angazhuar dhe ka qenë sidomos ndihmues për ekipet e Policisë dhe të Drejtësisë⁴³. OSBE-ja ka kontribuar në fushën e legjislacionit dhe në mbikëqyrjen e parlamentit. Gjithashtu OSBE-ja ka rol pozitiv në projekte të ndryshme në arsimimin e lartë nëpër universitete publike, në projektet njohëse e arsimore të universiteteve. Misioni i OSBE-së ka qenë dhe do të jetë i nevojshëm edhe për shumë kohë në ndërtimin e rendit dhe çështjeve me rëndësi në Kosovë deri te finalizimi i proceseve drejt BE-së. Prandaj OSBE-ja herë pas here është në një pozitë të ndjeshme që të vazhdojë të mbështesë, kontribuojë në përpjekjet e Kosovës për të vazhduar parimet demokratike, për të ndërtuar një shoqëri transparente dhe për t'iu përmbajtur praktikave të qeverisjes së mire. Mbikëqyrja e proceseve zgjedhore, politike, për të avancuar

⁴¹ Bejtush G Xhelal J, 2013, "Sistemi i Menaxhimit të Krizave", fq. 297. 95 Line King dhe Whit Mason, 2007, "Paqe me Çdo Kusht-Si dështoi bota në Kosovë", Prishtinë, fq. 272, Raporti i OSBE-së, 1999.

⁴² Deri në nëntor 2009, Kosova është njohur nga 35 shtete pjesëmarrëse të OSBE, Organization for Security and Co-operation in Europe, Permanent Council, Decision No.305, PC.DEC/305, 1 July 1999,

⁴³ OSBE-ja dhe EUPT-ja takohen rregullisht si në nivel ekspertësh po ashtu edhe në nivel shefave të Misioneve për të bashkërenduar aktivitetet në sektorin e Policisë dhe atë të Gjyqësisë. Ekspertët e EUPT-së takohen rregullisht dhe në baza ad hoc me homologët nga Zyra e Misionit në Kosovë. 110 OSBE-ja, në të ardhmen do të mbështesë edhe shumë projekte të tjera, me theks të veçantë njohjen e diplomave të Universitetit të Prishtinës jashtë vendit, sipas procesit të Bolonjës.

reformat në qeverisjen lokale, reformave gjyqësore së bashku me misionin EULEX do të jetë një shtytje e drejtpërdrejt dhe garant për të ardhmen europiane të Kosovës.

Roli i UNMIK-ut në Kosovë para dhe pas Pavarësisë

UNMIK ishte formuar në bazë të Rezolutës 1244, si mision të vetin kishte që ta ndihmojë popullin e Kosovës për të rindërtuar jetën e tyre. Baza legale ishte karta e OKB-së, që i dha legjitimitet për pjesëmarrje në misione paqeruajtës kuresë qëllimi ishte vendosja në Kosovë si përkrahje dhe mbrojtje. Me misionin e UNMIK-ut, Kosova përkohësisht administrohej nga OKB-ja dhe nën administrimin e BE-së, përmes misionit të OSBE-së. Pas përfundimit të luftës në Kosovë, çështja më e rëndësishme që donte përkushtim ishte krijimi i kushteve për kthimin e refugjatëve të dëbuar nga territori i Kosovës. Ky angazhim ishte një praktikë e rëndë dhe e ndërlikuar për bashkësinë ndërkombëtare. Ndër problemet sfiduese ishin: kthimi i refugjatëve dhe personat e zhvendosur në shtëpitë e tyre të sigurt dhe të papenguar. Kthimi i refugjatëve ishte njëri nga qëllimet dhe rezultatet kryesore të misionit të UNMIK-ut, kur dihet se më shumë se 1000.000 njerëz ishin larguar si pasojë e luftës. Problem tjetër ishte zbulimi i viktimave, kthimi i të burgosurve. Roli aktiv i UNMIK-ut ka qenë edhe ofrimi i garancisë dhe sigurisë civile popullit në Kosovë. Si garantuese të ligjit civil dhe rendit fillimisht e kishte në kompetencë personelin e policisë ndërkombëtare, ndërsa qëllimi përfundimtar ishte formimi i një force policore lokale si garanci më jetë gjatë të mëtejme të proceseve paqebërëse dhe ndërtuese të Kosovës. Gjithashu një ndër sfidat më të mëdha ishte rindërtimi ekonomik e sociale që ishte një nevojë e madhe dhe urgjente për popullin Kosovës. UNMIK-ut si një mision I përkohëshëm kishte për qëllim transferimin gradual të kompetencave tek institucionet lokale, respektivisht zëvendësimi i legjitimitetit etatik me legjitimitetin demokratik që do të instalohet përmes zgjedhjeve të lira në Kosovë⁴⁴. Një ndër problemet kryesore që ballafaqohej UNMIK-u pas luftës, ishin edhe marrëdhëniet me grupet etnike veçanërisht atijë serbë. Që nga 2001 e këndej situata e sigurisë gradualisht është përmisuar, kështu që sfida kryesore e UNMIK-ut dhe Qeverisë së Kosovës, ishte mbrojtja e minoriteteve dhe inkuadrimi i tyre në jetën shoqërore dhe në institucionet kosovare. Një prezencë tjetër, në të ardhmen e UNMIK-u, do të ishte e vlerësuar si çështje asistente, sa i përket çështjeve ndëretnike dhe në çështjet e zbardhjes së krimeve të luftës që akoma janë të pazgjidhura. Kosova do të ketë një ndihmës edhe në çështjet e njohjeve të Kosovës në të ardhmen nga shtetet anëtare të OKB-së ku ky mision është edhe si pjesë e kësaj organizate. UNMIK-u, mund të ketë rol të një llojë ure si bashkëpunimi me Qeverinë e Kosovës.

Bartja e kompetencave dhe transferimi i shërbimeve doganore nga UNMIK-u tek institucionet kosovare, ishte e qartë se ky mision është në fundin e tij. Ardhmëria e tij, si mision në Kosovë, dalëngadalë po

⁴⁴ Rasti i Shërbimit Policor nga ana e Policisë së UNMIK-ut, u bë transferimi i kompetencave tek autoritetet e Policisë së Kosovës.

shuhet. Vetë rikonfigurimi i UNMIK-ut, i hap edhe rrugë në një masë misionit të OSBE-së, të vazhdojë edhe më tej fushëveprimtarin e caktuar që dotë bartë edhe në të ardhmen.⁴⁵

Një gjë duhet të kemi të qartë se mandati i këtij misioni, nuk do të ketë asnjëherë më rol udhëheqës, por tash e tutje, për shkak të punëve që Qeveria e Kosovës do t'i udhëheqë vetë çështjet me rendësi, pasi që Kosova u pavarësua dhe u njoh ndërkombëtarisht si shtet, tregon qartë rolet e mëtutjeshme, një gjë të tillë e faktin edhe nxjerrja e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (15 qershor 2008),⁴⁶ duhet ditur se të gjithë misionet tani do të jenë de jure nën ombrellën e kësaj kushtetute dhe se përgjegjësitë dhe barra është e vetë institucioneve të Kosovës dhe askush tjetër. Ishte shumë me rendësi që paraqitja e progresit të BE-së, në bashkëpunim me UNMIK, në çështjet progresive dhe rolit mbizotërues të institucioneve të Kosovës, për një qeverisje sa më të mirë për çështjen e së ardhmes së Kosovës. Ngase kjo si objekt ishte i përkryer nga siguria europiane e misionit policor në kuadër të EULEX-it, nën mbikëqyrjen e përfaqësuesit specialë të BE-së.⁴⁷

3.4 Vednimi I GJND-së per Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës

Me kërkesë të republikës së Serbisë, asambleja e Përgjithshme kërkon Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, me rezolutën 63/3 e miratuar me 8 tetor 2008, me 77 vota për, 6 kundër dhe 74 abstenime, organit kryesor gjyqësor të Kombeve të Bashkuara, dhënien e një mendimi këshillëdhënës në pyetjen nëse Deklarata e Pavarësisë së Kosovës është në pajtim me të drejtën ndërkombëtare.⁴⁸ Më 30 janar 2009, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së i ka dorëzuar Gjykatës një dosje me dokumente që mund të hidhnin dritë në pyetjen e kërkuar. Gjykata ka përcaktuar afatet kohore brenda të cilave shtetet e interesuara do të mund të paraqisnin deklaratat, përkatësisht komentet me shkrim, si dhe më vonë ka vendosur dhe përcaktuar dinamikën e mbajtjes së seancave dëgjimore. Gjykata e ka ftuar edhe Kosovën që të paraqesë kontributet me shkrim dhe të marrë pjesë në seancat dëgjimore.⁴⁹

Menjëherë pas kërkesës së Asamblesë së Përgjithshme për mendim këshillëdhënës nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, institucionet e Republikës së Kosovës kanë ndërmarrë veprimet e duhura për të ndërtuar një mbrojtje sa më të fortë dhe për të përfaqësuar Kosovën në Gjykatë. Më 15 tetor 2008, Presidenti dhe Kryeministri kanë autorizuar Ministrin e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës ta përfaqësojë Republikën e Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Në fazën e parë me shkrim,

⁴⁵ Plani Gjashtë Pikësh të Ban Ki-Moon, sekretari general i OKB.

⁴⁶ Kosova deri në fund të vitit 2008 është njohur nga më shumë se 47 shtete më me ndikim dhe zhvillim në botë ndërsa deri në dhjetor 2013 Kosovën e kanë njohur mbi 98 shtet, Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila hyri në fuqi me 15. Qershor 2008, Michail Raith, 2008, "Project Stability in Time of Crisis-The European Union's Responsibility towards the Western Balkans". Në: Suedosteuropa Mitteilungen, fq. 12.

⁴⁷ R.G Feltham, Diplomatic Handbook, Fifth edition, Longman Groupn UK Limited, 1988, f 62-72

⁴⁸ Kosovo in the Internatioanl court of Justice, faqe 11, shih; www.mfa-ks.net/assets/cms/uploads/files/Burime/Kosovo%20in%20the%20International%20Court%20of%20Justice/kosova-ne-gjykatën-nderkombetare-te-drejtësisë.pdf

⁴⁹ Njëjtë faqe 11,

deri më 17 prill 2009, 37 shtete kanë dorëzuar deklarata me shkrim. Në fazën e dytë, atë të komenteve ndaj deklaratave me shkrim, komente me shkrim kanë paraqitur 15 shtete. Në periudhën midis 1 dhe 11 dhjetorit 2009, Gjykata ka organizuar seanca dëgjimore, me të cilin rast argumentet e tyre i kanë paraqitur 29 shtete. Republika e Kosovës ka marrë pjesë në të gjitha fazat e procesit në Gjykatë.⁵⁰ Për her të parë në historinë e Gjykatës që të pesë anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit (Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Federata Ruse dhe Kina), kanë marrë pjesë në një proces këshillëdhënës. Procesi është karakterizuar nga një pjesëmarrje numerikisht shumë e madhe e shteteve anëtare të OKB-së. Gjykata konstatoi, me shumicë dërmuese, se Deklarata e Pavarësisë së Kosovës nuk ka shkelur të drejtën ndërkombëtare. Mendimi i Gjykatës ishte eksplicit dhe i qartë, duke vendosur në favor të Kosovës në të gjitha pikat gjithashtu gjykata e kishte rikonfirmuar besimin dhe menyrën konsistete në drejtësin ndërkombëtare, sikundër edhe besimin në të drejtën e natyrëshme të popullit të Kosovës, për liri dhe për të caktuar fatin e vetë.⁵¹

Vlen të përkujtohet që për dallim nga aktgjykimet e nxjerra në kuadër të procedurës kontestimore, mendimet konsultative të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë nuk kanë një forcë juridike të obligueshme për palët të cilave u drejtohen ato. Mendimi konsultativ nuk është një akt gjyqësor në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, por vetëm një shprehje e pikëpamjes së Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi çështjen që i është nënshtruar për konsultim. Sidoqoftë, mendimet konsultative kanë një rëndësi të pakontestueshme sa i përket konstatimit të së drejtës ndërkombëtare pozitive dhe zënë të njëjtin vend në kuadër të jurisprudencës së Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, si dhe aktgjykimet e nxjerra në ushtrim të kompetencës së saj kontestimore. Në praktikë, mendimet konsultative kanë një autoritet moral ndaj shteteve, të cilat në të shumtën e rasteve pranojnë të sillen në pajtim me të.⁵²

Në rastin e Kosovës, mendimi konsultativ i GJND-së pritshmëria ishte se do kishte ndikim pozitiv në rrjedhën e njohjes ndërkombëtare të shtetit të Republikës së Kosovës. Gjithashtu pritshmëria ishte se në qoftë se vendimi i GJND do ishte kundër shpalljes së pavarësisë do të ndikonte në tërheqjen e njohjeve në këto rates gjykata nuk disponon me asnjë mjet juridik për t'i detyruar shtetet për një gjë të tillë. Efekti i një mendimi të tillë do të jetë më i shprehur sa i përket qëndrimit të shteteve hezituese apo atyre që kundërshtojnë kategorikisht pavarësinë e Kosovës, duke u ofruar një argument juridik për të mos njohur shtetin e ri të Kosovës.

Opinionin Këshillëdhënës i GJND-së ishte i qartë, se Deklarata e Pavarësisë nga institucionet e Kosovës ishte në përputhje me ligjin ndërkombëtar. Në aspektin komperativ, legjitimiteti i pavarësisë së Kosovës

⁵⁰ Kosovo in the Internatioanl court of Justice, faqe 13,shih; www.mfa-ks.net/assets/cms/uploads/files/Burime/Kosovo%20in%20the%20International%20Court%20of%20Justice/kosova-ne-gjykatën-nderkombetare-te-drejtësisë.pdf

⁵¹ Njeite faqe 14

⁵² Njeite faqe 14

mund të krahasohet me disa vende të tjera që si rezultat i vazhdimësisë së tyre nga një territor tjetër të ketë fituar pavarësinë. Sipas të drejtës ndërkombëtare, Kosova i përmbush të gjitha kriteret të jetë një shtet i pavarur siç edhe është e paraparë nga Konventa e Montevideos (1933). Kosova i përmbush të gjitha kriteret për të qenë shtet i pavarur dhe sovran. Nëse bëhet fjalë për territorin – në OKB ka 34 shtete me territor më të vogël se Kosova; nëse bëhet fjalë për popullatën – në OKB janë 58 shtete me numër më të vogël të popullsisë se të Kosovës. Një tjetër fakt që dëshmon subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës është njohja nga mbi 100 shtete anëtare të OKB-së. Shpallja e Mendimit të GjND-së, për ligjshmërinë e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës shënon arritjen më të çmueshme në konsolidimin ndërkombëtar të shtetësisë. Ky mendim ka konfirmuar në mënyrë të qartë dhe shprehës se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk ka cenuar asnjë normë ligjore të së drejtës ndërkombëtare.⁵³

3.5 Sfidat e Republikës së Kosovës drejtë antarsimit në Bashkimin Evropian

Republika e Kosovës në rugën e saj drejtë Bashimit Evropian ballafaqohet me një vargë sfidash që në masë të madhe edhe e vështirsojnë rugën e saj drejtë antarsimit në BE dhe njëkohësisht kanë të bëjnë edhe me plotësimin e kushteve dhe kriterëve të vendosura nga vetë BE që një shtet aspirant duhet ti plotësoj:

Përmbushja e kriterëve

Republika e Kosovës në rugën e saj drejtë BE obligim kryesor ka përmbushjen e standardeve dhe kriterëve të Kopenhagës, të vendosura nga Këshilli Evropian në vitin 1993, të cilët kanë të bëjnë me forcimin i shtetit ligjor, të drejtat e njeriut, respektimi i pakicave, ekonomi funksionale të tregut dhe përmbushja e legjislativitetit. Kriteret e Kopenhagës, përfshihen kërkesat, kushte dhe obligimet që një shtet duhet t'i përmbushë në mënyrë që të bëhet anëtar e BE. Për këtë qëllim, Bashkimi Evropian ka përpiluar një vargë mekanizmesh për ta lehtësuar dhe për të asistuar Kosovën në kuadër të Ballkanit Perëndimor, në përmbushjen e Kriterëve të Kopenhagës.

Kriteret e Kopenhagës janë:

- Kriteri politik;
- Kriteri ekonomik;
- Kriteri i Standardeve Evropiane:

Kriteri politik;

Kriteri politik janë: Demokracia dhe Sundimi i Ligjit, Mbrojtja e të Drejtave të njeriut dhe pakicave, Intensifikimi i Bashkëpunimit Rajonal. Demokracia dhe sundimi i ligjit – me anë të këtij kriteri kërkohet që të promovohen proceset demokratike dhe hartimi i ligjeve konform standardeve Evropiane, nënkupton standardizimin me legjislativitetin BE. Në rastin e Kosovës, më problematikët janë

⁵³ Bujar Desku "Interpretimi i Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës nga GjND, Shtëpia Botuese Faik Konica, 2013.

kryesisht sektorët e qarkullimit të mallrave dhe të njerëzve, prokurorimit publik, dhe kontrollit financiar. Në këtë grup përfshihet edhe reformat e Institucioneve, reformat në procesin e zgjedhjeve të përgjithshme dhe atyre lokale, administrata publike, sistemi gjyqësor, qeverisja lokale dhe aspekte të tjera.⁵⁴Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe pakicave duhet të bazohet në Deklaratën Ndërkombëtare për të drejtat njetore dhe të pakicave që duhet edhe ta garantojë vetë kushtetuta. Për tu aritur mbrojtje efikase e të drejtave të njeriut dhe të pakicave duhet të krijohen mekanizma për implementimin e këtyre të drejtave dhe fuqizimin e institucioneve efikase ku do të monitorohen, shqyrtohen dhe mbrohen të drejtat humane dhe të minoriteteve.⁵⁵ Me mbrojtjen e të drejtave të njeriut nënkuptohet edhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, të drejtat e minoriteteve të ndryshme në Kosovë, të drejtat e grave, respektivisht barazinë gjinore si dhe shumë aspekte të tjera. Intensifikimi i Bashkëpunimit Rajonal, është një nga kushtet e rëndësishme për integrim në BE nënkupton edhe konsolidim të marrëdhënieve ndërmjet vendeve të Ballaknit Përendimor. Bashkimi Evropian tenton që këto vende të detyrojë që të intensifikojnë bashkëpunimin dhe tejkalojnë problemet e tyre. Kosova duhet të vazhdojë pjesëmarrjen në iniciativat rajonale si Këshillin për Bashkëpunimin Rajonal , në CEFTA etj.

Kriteri ekonomik:

Kriteret ekonomike janë; Privatizimi dhe ristrukturimi i ndërmarrjeve publike, Qëndrueshmëria Buxhetore dhe ekonomike, zhvillimin e sektorit financiar, ngritja e kapaciteteve njerëzore, integrimi ekonomik në Bashkimin Evropian. Privatizimi dhe ristrukturimi i ndërmarrjeve publike, privatizimi i mirfillt dhe transparent do të ndikojnë në krijimin e vendeve të reja të punës, rritje të nivelit të eksportit dhe arritjen e objektivave zhvillimore në përgjithësi për Kosovën. Qëndrueshmëria Buxhetore dhe ekonomike nënkupton stabilitet makroekonomik. Aspekt tjetër me rëndësi është edhe bashkëpunimi i qëndrueshëm me FMN –në , Bankën Botërore, për të planifikuar zhvillimin ekonomik.⁵⁶

Kriteri i standardeve Evropiane, bëjnë pjesë : Tregu i brendshëm, Politikat Sektoriale, Liria, Siguria dhe qështjet e tjera. Tregu i brendshëm Fuqizimi i kapaciteteve administrative të institucioneve për adaptimin dhe krijimin e konsistencës së politikave të vendit konform kërkesave të BE. Politikat Sektoriale, Integrimi Evropian është një proces që kërkon përfshirjen dhe ndryshimin e politikave, kornizës institucionale, dhe legjislacionit në mënyrë që vendi të përmbushë kriteret e BE- së në të gjitha fushat, is psh, Industria dhe mbështetja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, bujqësia, mjedisi, transporti, energjia, shoqëria informatike dhe mediat, kontrolli financiar, statistikat,. Liria, Siguria dhe qështjet e

⁵⁴ “Reformat e Administratës publike në Republikën e Maqedonisë drejt Integritimit Evropian”, Abdulla A, 2008, Tetovë, fq. 59.

⁵⁵ Hyrje në Mbrojtjen Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, Instituti për të Drejtat e Njeriut, Univeriteti ABO Akdemisl 1999, R.Hanski&M.Suksi f.81-94.

⁵⁶ Integrimi i Kosovës në Bashkimin Evropian, Prof.Dr.Armand Krasniqi Msc.Cand.Visare Ndreca, faqe 3-5.

tjera, në kuadër të këtij kriteri si më të rëndësishme janë: regjimi i vizave, migrimi, shpërlarja e parave, luftimi i krimit të organizuar, policia, mborjtja e të dhënave personale etj.

Sfidat e Republika e Kosovës në rugën drejtë antarsimit në BE, kanë të bëjnë kryesisht me funksionimit të shtetit ligjore dhe pavarësimin e sistemit gjyqësorë, ku BE ka vërejtur ngecje dhe ndërhyrje të politikës. Republika e Kosovës ka ngecje serioze në funksionimin e sistemit gjyqësor të pavarur, në shumë raporte vjetore të BE, është vërejtur ndikim serioz të politikës në proceset gjyqësore në veçanti kur ka të bëjë me akuzat e ngritura për bartësit e funksioneve të larta shtetërore, gjith ashtu vërehet edhe mos efikasitet të sistemit gjyqësor ku janë të grumbulluar numër I madhë I lëndëve të pa zgjidhura. Një ndër sfidat më kryesore dhe që është kushtë për liberalizimin e vizave për Republikën e Kosovës është luftimi I korupsionit në nivele të larta të aparatit shtetëror, në raportin e vitit 2015 të BE, për Kosovën, vëren se korupsioni në nivele të larta të aparatit shtetërore ka marrë përmasa “endemike”, dhe kërkon angazhim më të madhë në luftimin e korupsionit.⁵⁷

Për avancion në rugën e vetë drejtë BE, Republika e Kosovës, përveç luftimin e korupsionit, krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe efikas penges paraqitet edhe mos njohja e pavarësisë nga pesë (5) shtetet antare të BE, (Romania, Spanja, Greqia, Qipro dhe Slovakia).

✓ QIPRO

Qipro nuk ka as marrëdhënie zyrtare as jozyrtare me Republikën e Kosovës. Qëndrimi ndaj Kosovës është i prerë sa nuk njih as dokumentet e Kosovës. Ndryshimi i politikës do të bazohet në rezultatin e dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit.⁵⁸

✓ GREQIA

Greqia sikur edhe Qipro nuk e ka njohur shpalljen e njëanshme të pavarësisë së Kosovës. Arsyet e mosnjohjes së pavarësisë së Kosovës nga shteti Grekë janë: Kundërshtimi i hapur i së drejtës ndërkombëtare; Keqtrajtimi i pakicave në veçanti të pakicës asaj serbe; Krimi I organizuar dhe korupcioni, Për dallim nga Qipro, Athina ka ruajtur kanalet zyrtare të komunikimit me Prishtinën, ka hapur zyrë ndërlidhëse në Prishtinë, ka pranuar dokumentet e lëshuara nga autoritetet e Kosovës, ka lehtësuar komunikimin dhe transportin e qytetarëve ndërmjet Kosovës dhe Greqisë dhe ka përkrahur tregtinë dhe investimet ndërmjet dy palëve. Përveç kësaj, Greqia ka lejuar që Kosova në Athinë të hapë zyrën e sajë në fillim do jetë zyrë për bashkëpunim ekonomik që jepë edhe sinjal për ndryshim të politikës së jashtëme karshi njohjes së pavarësisë së Kosovës.⁵⁹

⁵⁷ Plani Kombëtar Zhvillimor i Kosoves 2007 – 2013- Strategjia Sektoriale për Integrim Evropian, Qeveria e Kosoves 2007.

⁵⁸ Mirishahe S, Kosova përballë 5 vendete antare të BE që nuk e kanë njohur pavarësinë, KIPRED, Instituti Kosovarë për kërkime dhe zhvillim të politikave, Prishtinë 2013, F.3

⁵⁹ Njejtë f 3-4,

✓ RUMANIA

Rumania nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës, ndër arsyt kryesore është problemi me pakicën hungarez, ndërsa dhe ka paraqitur argumente gjithëpërfshirëse kundër në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND). Me Prishtinën nuk janë vendosur kurrfarë marrëdhëniesh diplomatike dhe nuk ka pasur ndonjë komunikim zyrtar institucional, përveç një zyre ndërlidhëse nën mandatin e KB-së. Madje edhe para pavarësisë, kur Kosova ishte krahinë nën UNMIK-un, nuk kishte marrëdhënie as zyrtare e as jozyrtare ndërmjet Rumanisë.⁶⁰

✓ SLLOVAKIA

Sllovakia, si një prej shteteve që nuk e ka pranuar pavarësinë e Kosovës deri më tani për dallim nga Romania është treguar më e moderuar sa i përket kontakteve liberale, ka hapur zyrën ndërlidhëse në Prishtinë. Sllovakia nuk ka marrë pjesë në përgatitjen e Misionit të BE-së në Kosovë për Politikën e Përbashkëta për Siguri dhe Mbrojtje në misionin e BE, EULEX-I ka marrë pjesë në mënyrë simbolike vetëm me oficerë policorë.⁶¹

✓ SPANJA

Zyrtarisht, Spanja nuk e ka njohur Kosovën për arsye që zakonisht janë cituar nga ata që e kundërshtojnë atë: përmendja e sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës Federale të Jugosllavisë në Rezolutën 1244, statusi i Kosovës si krahinë e Serbisë në Jugosllavi, mungesa e marrëveshjes ndërmjet palëve ose një rezolutë e KB-së, krijimi i një shteti ‘për arsye krejtësisht etnike. Poshtu respektimi i tri parimeve: e drejta ndërkombëtare, stabiliteti rajonal dhe uniteti i veprimit i Bashkimit Europian. Për dallim nga shumica e vendeve mosnjohëse që kanë interesa në rajon, Spanja shkëputi çdo lidhje të përfytyrueshme me autoritetet e Kosovës së pavarur dhe hoqi dorë nga çdo lloj përfaqësimi në Prishtinë, qoftë në formën e zyrës së për ndërlidhje. Qëndrimi zyrtar ishte që Spanja parapëlqente një zgjidhje me marrëveshje dhe nuk i pëlqente shpallja e njëanshme e pavarësisë, por që do të kontribuonte në qëndrimin e përbashkët euro-atlantik dhe, në veçanti, të BE-së. Spanja nuk e ka ndryshuar qëndrimin e saj themelor kundër njohjes që nga shkurti 2008, por nuk do të thotë që ajo ka qëndruar si vëzhguese pasive e situatës. Në të vërtetë, Spanja ka ndërmarrë nisma dhe i ka bllokuar ato dhe ka mbetur aktive si dhe reaguese gjatë gjithë

⁶⁰ Njejtë f.4

⁶¹ Njejtë f.4

periudhës. Një arsye tjetër që nuk njih pavarësinë e Kosovës, është edhe kërkesa e vazhdueshme e Katalunjës për pavarësi dhe që Spanja e trajton në një linjë si statusi i Republikës së Kosovës.⁶²

3.6 Strategjia për aritjen e njohjes së plotë ndërkombëtare të Republikës së Kosovës

Strategjia për njohje është kornizë që mundëson mekanizma më të ndryshëm, më të thellë dhe më të gjithanshëm për të arritur qëllimet strategjike të Kosovës edhe atë antarsimi në organizatat më të rëndësishme ndërkombëtare, siç janë: antarsimi në OKB, OSBE, Këshillin e Evropës, Interpol etj si dhe shtimin e numrit të njoheve edhe nga shtete të cilët nuk e kanë njohur pavarësinë e Republikës së Kosovës.⁶³

Që nga shpallja e pavarësisë ruga drejtë njohjes ndërkombëtare ishte i kushtëzuar nga rrethanat e veçanta politike dhe ligjore ndërkombëtare, në të cilat ishte pavarësuar Republika e Kosovës. Praktika ndërkombëtare e legjitimitimit ndërkombëtar të shteteve të reja, që nga krijimi i OKB-së, dëshmon se ky proces është realizuar, kryesisht, përmes anëtarësimit në OKB. Kjo, në thelb, ka nënkuptuar njohje kolektive të shteteve të reja, duke i bërë praktikisht të panevojshme njohjet nga shtetet veç e veç.⁶⁴

Në rastin e Kosovës, mungesa e konsensusit në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për mbështetjen e propozimit të të dërguarit të posaçëm të OKB-së për statusin e Kosovës, Presidentit Martti Ahtisaari, për shkak të kundërshtimit të Rusisë, e ka detyruar Kosovën që të ndjekë rrugën e njohjeve individuale, për të arritur integrimin e plotë në bashkësinë ndërkombëtare. Rruga për sigurimin e njohjeve individuale është rruga më e vështirë dhe merr më shumë kohë. Asnjë nga fqinjët e Kosovës nuk kanë arritur më shumë se disa dhjetëra njohje formale bilaterale sepse njohjen e kanë siguruar nëpërmjet Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Kosova duhet të përcjellë rrugët paralele për të arritur – një nga një, numrin më të madh të mundshëm të njohjeve, por po ashtu për t'i përmbushur obligimet në mënyrë që vendi të bëhet anëtar i barabartë i OKB-së dhe BE-së⁶⁵. Shpallja e pavarësisë së Republikës së Kosovës më 17 shkurt 2008 u pasua me një valë të shpejtë të njohjeve nga më shumë se 50 shtete brenda 6 mujorit të parë. Në ndërkohë, Republikën e Kosovës e kanë njohur 25 shtete të tjera. Njohjet e menjëhershme dhe të fuqishme ndërkombëtare të Kosovës ishin rezultat i përpjekjeve të bashkërenduara të Kosovës me vendet përkrashë të pavarësisë. Këto njohje në masë të madhe e konsoliduan pavarësinë e Kosovës dhe e bënë fakt të pakthyeshëm gjeopolitik edhe për kundërshtarët më të mëdhenj të shtetësisë së saj. Kosova është e njohur nga të gjithë fqinjët e saj, përveç Serbisë, shumica absolute e vendeve të Evropës, 22 nga 27 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE), 25 nga 29 shtete të NATO-s, 7 nga 8 shtetet anëtare të G-8, si dhe një numër vendesh nga të gjitha kontinentet.⁶⁶ Republika e Kosovës në periudhë që vjen duhet të

⁶² Njejtë f.5

⁶³ Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia për aritjen e njohjes së plotë ndërkombëtare, Qershor 2011, f.3

⁶⁴ Njejtë f.7

⁶⁵ Njejtë f. 7

⁶⁶ Njejtë f.8

ndjek interes strategjike djekë një orientim strategjik, i cili që të arijë qëllimin e e vtë strategjik antasimi në OKB-së, NATO-s dhe BE-së, duke siguruar numër optimal të njohjeve nga shtetet dhe organizmat multilateralë. Ky synim do të mundë të realizohet në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me partnerët strategjikë që ndihmuan në çlirimin dhe në shpalljen e pavarësisë.

- ✓ Shtetet individualisht: Ky drejtim përfshinë punën me shtetet veç e veç varësisht nga profili i tyre i përgjithshëm, faktorët dhe dinamikat e politikës së jashtme dhe, posaçërisht, pozicionimi i tyre ndaj pavarësisë së Kosovës.⁶⁷
- ✓ Grup-shtetet dhe rajonet e caktuara: Ky drejtim ka për qëllim përshtatjen e veprimeve për njohje ndaj faktorëve dhe dinamikave politike në rajone dhe grup-shtete të caktuara, të cilat ndikojnë në vendimmarrjen e politikës së jashtme të shteteve përkatëse. Ky kategorizim nis prej premisë se politikat e jashtme të disa vendeve janë të ndërlidhura ngushtë dhe shpesh operojnë në vijë dhe pajtim me politikat e grup shteteve të caktuara ose me politikat rajonale të rajoneve apo të mekanizmave të caktuar rajonalë⁶⁸.
- ✓ Organizatat dhe mekanizmat ndërkombëtarë: Realizimi i qasjeve të veçanta dhe krijimi i lidhjeve me organizata dhe mekanizma shumëpalësh, për afirmim dhe njohje të Kosovës si subjekt ndërkombëtar.⁶⁹

ARGUMENTET E PËRGJITHSHME PËR NJOHJE TË PËRDORUR NGA REPUBLIKA E KOSOVËS

- Kosova është një nga shtatë shtetet e pavarura që janë krijuar nga shpërbërja e dhunshme dhe jo-konsensuale e ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Kosova ka qenë pjesë konstitutive e një shteti federal i cili nuk ekziston më si subjekt i së drejtës ndërkombëtare.
- Në ish Jugosllavi, Kosova kishte përfituar atributet e qarta shtetërore si të njëjtit të tjera federale, duke përfshirë: Kushtetutën, përfaqësuesit e vet në të gjitha institucionet federative (Kryesinë Kolektive, Kuvendin, Këshillin Ekzekutiv Federativ, Qeverinë Federative, Gjykatën Kushtetuese), Kryesinë, Kuvendin, Qeverinë, Policinë, Mbrojtjen Territoriale, Gjykatën Kushtetuese, Shërbimin e Inteligjencës, Bankën Qendrore, Sekretariatën për Marrëdhënie Ndërkombëtare, etj.
- Kosova në ish-federatën jugosllave ka pasur të drejtën e vetos dhe të drejtën e pjesëmarrjes së barabartë me njësitë e tjera federale në të gjitha institucionet kyçe federale, si në Kryesinë Kolektive Federale, Qeverinë Federale dhe Parlamentin Federal.

⁶⁷ Njejtë f.14

⁶⁸ Njejtë f.14

⁶⁹ Njejtë f.14

- Kufijtë e Kosovës sikurse edhe kufijtë ndërkombëtarë të jashtëm të ish-federatës jugosllave kanë qenë të mbrojtur me kushtetutë, dhe nuk kanë mundur të ndryshohen pa pajtimin e kuvendeve të këtyre njësive federale, përfshirë edhe Kuvendin e Kosovës.
- Shpërbërja e ish-Jugosllavisë filloi me suprimimin e dhunshëm të statusit federal të Kosovës nga Serbia (më 1989), në kundërshtim me Kushtetutën e ish-federatës dhe Kushtetutën e Kosovës. Ky suprimim i dhunshëm, është kundërshtuar dhe nuk është pranuar asnjëherë nga institucionet dhe populli i Kosovës.
- Pas suprimimit të statusit federal, Kosova iu nënshtrua dhunës dhe persekutimit sistematik, rrënimin ekonomik dhe politikës së aparteidit, me qëllim të ndryshimit demografik të Kosovës, siç është dokumentuar pa asnjë fije dyshimi në rezolutat e OKB-së dhe raportet e shumta të kohës nga organizata si Helsinki Watch, Amnesty International, etj.
- Kosova, në rrethana të okupimit nga Serbia, ka ndjekur rrugën e vet të mëvetësimit, përmes krijimit të institucioneve demokratike dhe përfaqësuese shtetërore, dhe me mbajtjen e referendumit për pavarësimin e Kosovës (shtator 1991).
- Politika shtet-ndërtuese e Kosovës në vitet e nëntëdhjeta është mbështetur në rezistencën politike me mjete paqësore, përkundër persekutimit dhe represionit të vazhdueshëm, si dhe politikës luftënxitëse të Serbisë. Kosova është shteti i vetëm evropian që ka dy fitues të Çmimit prestigjioz Sakhariv të Parlamentit Evropian, që mbajnë dy ikonat e disidentizmit politik dhe luftës paqësore: Presidenti i ndjerë Rugova dhe Adem Demaçi.
- Përkundër përpjekjeve për zgjidhje paqësore nga ana e Kosovës, më 1998, Serbia nën Miloseviçin filloi luftën në Kosovë, pas tri luftërave që inicioi në Slloveni, Kroaci dhe Bosnje-Hercegovinë.
- Që në fillim të luftës në Kosovë më 1998, Serbia filloi të zbatojë matricën e pastrimit etnik dhe politik të aplikuar më herët në Bosnje-Hercegovinë. Kjo u karakterizua me vrasje masive të civilëve shqiptarë (rreth dymbëdhjetëmijë brenda një afati të shkurtë kohor), shkatërrim të pronës, përdhunime masive dhe dëbim të më shumë se 900 mijë njerëzve, që përfshinë gjysmën e popullsisë së Kosovës. Krimet brutale dhe natyra politike e tyre është dëshmuar pa asnjë fije dyshimi në proceset e ndryshme nga Tribunali i Hagës kundër lidershit serb.
- Përpjekjet ndërkombëtare për zgjidhje të negociuar të çështjes së Kosovës nuk dhanë rezultate dhe përfunduan me refuzimin e Serbisë të Marrëveshjes së Rambujesë, të sponsorizuar nga Bashkësia Ndërkombëtare (shkurt-mars 1999). Marrëveshja e përkrahur nga Grupi i Kontaktit po ashtu ka sjellë kushtin që statusi i Kosovës të bëhet “në përputhje me dëshirën” e popullit të Kosovës.
- Rezistenca ushtarake e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka përfaqësuar një luftë legjitime të të shtypurit ndaj okupuesit dhe paraqet pikë të ndritshme në historinë moderne evropiane si një lëvizje

- që ka qenë e fokusuar ekskluzivisht vetëm në mbrojtje të popullatës civile dhe vendit të okupuar nga jashtë, pa rrezikuar apo sulmuar vende tjera.
- Ndërhyrja ushtarake e NATO-s (mars-qershor 1999), i dha fund kësaj përpjekjeje brutale të shtetit serb dhe i hapi rrugë vendosjes së administrimit ndërkombëtar në Kosovë, duke mundësuar kthimin e popullatës së dëbuar.
 - Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 vendosi administrim të përkohshëm ndërkombëtar në Kosovë, duke i dhënë UNMIK-ut pushtetin më të lartë civil dhe KFOR-it atë ushtarak. Rezoluta 1244 suprimoi krejtësisht dhe pa dyshim sovranitetin e ish-RFJ-së mbi Kosovën, vendosi bazën për krijimin e institucioneve demokratike, duke përvijuar qartazi procesin për përcaktimin e statusit final të Kosovës.
 - Struktura shtetërore, politike, ekonomike dhe juridike e Kosovës u krijua gjatë administrimit ndërkombëtar (1999-2008), gjegjësisht nën ombrellën e OKB-së. Gjatë administrimit ndërkombëtar, Kosova ka krijuar sistemin e vet të pavarur të qeverisjes, sistemin e vet ligjor, doganor, monetar, politikën fiskale, tatimore, etj. Gjatë administrimit të përkohshëm, shumica e kompetencave që ndërlidhen me sovranitetin janë bartur tek institucionet vendore.
 - Në vitet 2005-2007 është zhvilluar procesi ndërkombëtar për përcaktim të statusit të Kosovës, i ndërmjetësuar nga i Dërguari i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për Statusin e Ardhsëm të Kosovës, ish-Presidenti i Finlandës, Martti Ahtisaari.
 - Në përmbyllje të procesit negociator, Ahtisaari ka propozuar pavarësinë e Kosovës, me një fazë fillestare të mbikëqyrjes ndërkombëtare. Sekretari i Përgjithshëm i OKB së e ka mbështetur plotësisht propozimin e të dërguarit të tij për çështjen e statusit të Kosovës.
 - Pas rekomandimit të të Dërguarit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB së për çështje të statusit dhe në bashkëpunim me akterët vendimtarë euro atlantikë, përfaqësuesit e zgjedhur në mënyrë demokratike të popullit të Kosovës kanë shpallur pavarësinë e vendit më 17 shkurt 2008. Në vijim të kësaj, Kuvendi I Kosovës ka miratuar Kushtetutën e vendit, pjesë e së cilës janë mekanizma të avancuar të mbrojtjes së pakicave, të decentralizimit, dhe të pranisë ndërkombëtare në Kosovë, siç janë propozuar nga Presidenti Ahtisari.
 - Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, duke iu referuar kërkesës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së të iniciuar nga Serbia, se a është shpallja e Pavarësisë së Kosovës në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, shpallë Mendimin Këshillëdhënës, më 22 korrik 2010, i cili në mënyrë të qartë konfirmon se shpallja e pavarësisë së Kosovës ka qenë në përputhje të plotë me të drejtën ndërkombëtare. Kjo ka rikonfirmuar fuqimisht qëndrimin e palës kosovare dhe të shteteve përkrähëse se Kosova është rast sui generis, mbështetur edhe nga fakti se pavarësia e Kosovës nuk ka shkaktuar kurrfarë efekti zinxhiror negative.

- Asambleja e Përgjithshme e OKB-së ka miratuar Rezolutën 64/298 (shtator 2010), e cila pranon Mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Pavarësinë e Kosovës. Kjo Rezolutë njëherësh u bën thirrje të dy shteteve (Kosovës dhe Serbisë) që të zgjidhin çështjet e tyre praktike me lehtësimin e Bashkimit Evropian.
- Dialogu i filluar mbi bazën e Rezolutës 64/298, ka për qëllim zgjidhjen e çështjeve teknike dhe normalizimin e marrëdhënieve ndërshtetërore Kosovë-Serbi, si dhe integrimin e tyre në Bashkimin Evropian.
- Procesi i njohjes së Republikës së Kosovës ka dëshmuar se shteti i Kosovës është realitet i pakthyeshëm si dhe faktor i pazëvendësueshëm i paqes dhe stabilitetit në rajon. Këtë më së miri e dëshmon fakti i njohjes së Kosovës nga të gjitha vendet fqinje (veç Serbisë), shumica dërmuese e shteteve të rajonit dhe komunitetit euroatlantik. Këto shtete, njëherësh janë prekur drejtpërdrejtë nga procesi i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe kanë kontribuar shumë në stabilizimin e rajonit. Shtetet në fjalë janë kontribuuesit kryesorë politikë, ekonomikë dhe ushtarakë në hapësirën e ish-Jugosllavisë.
- Kosova paraqet shembullin e shtetit të krijuar në bazë të shprehjes së vullnetit politik të shumicës dërmuese të popullsisë së saj. Ajo funksionon si shtet demokratik, me qeveri efektive dhe territor të definuar qartë, duke dëshmuar kapacitet të plotë për të hyrë në marrëdhënie ndërkombëtare.
- Serbia vazhdon politikën e saj konflikt-nxitëse në Ballkan, duke synuar cenimin e integritetit territorial të Republikës së Kosovës dhe Bosnje-Hercegovinës përmes përpjekjeve për krijimin e "konflikteve të ngrira" dhe destabilizimin e rajonit. Përpjekja e Serbisë për dominim rajonal dhe pretendime territoriale ndaj fqinjëve, është vazhdimësi e politikës e cila ka shkaktuar katër luftërat tragjike në ish Jugosllavi.
- Tribunali Penal Ndërkombëtar për Krime të Luftës në ish-Jugosllavi (ICTY), ka dënuar udhëheqës të lartë shtetërorë dhe ushtarakë të Serbisë për planifikimin dhe ekzekutimin e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit ndaj popullatës shqiptare në Kosovë.⁷⁰

⁷⁰ Njëjtë f. 15-19

KAPITULLI IV

4. NJOHJA E PAVARSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NGA ANA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË EDHE ZHVILLIMI I MARDHENIEVE BILATERALE

4.1 Historiku I mardhënieve Maqedoni –Kosovë

Në një të kaluar edhe jo shumë të gjatë historike mund të konstatohet se Maqedonia edhe Kosova ishin pjesë përbrëse, edhe pse me status të ndryshëm juridiko kushtetues, gati gjysëm shekulli kan qenë pjesë përbërse të një shteti të përbashkët Jugosllavinë. Me shpërbërjen e Jugosllavisë, Maqedonia fiton pavarinë si edhe ish republikat e tjera, ndëra Kosova në vitin 1989 do të humbë edhe autonomin dhe mbetet pjesë në Jugosllavisë së bashku me Malin e Zi, Sërbën dhe Vojvodinën.⁷¹ Sikur edhe në Bosnjë e Hercegovina, Kroacia edhe Kosova u përfshi në konflikt të armatosur ku me interevenimin e bashkësisë ndërkombëtare, që nga viti 1999 deri në vitin 2008 kur edhe shpalli pavarinë Kosova ishte nënë administrimin (protektorat) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Marrëdhëniet në mes Maqedonisë dhe Kosovës si shtete të pavarura, datojnë që nga viti 2008, dmth që nga njohja e pavarësisë së Kosovës nga ana e Republikës së Maqedonisë. Ngjarjet që kan ndodhur në Kosovë, kan qenë të një rëndësie të vaçant, duke mare parasyshe afërsin, lidhjet që kan pasur dhe vazhdojnë të kenë shqipatrët e Maqedonisë me Kosovën. Me Kushtetutën e SFRJ të vitit 1974, Kosova fiton më shumë kompetenca dhe pothuajse barazohet me statusin e republikave të tjera, por statusin përfundimtar të republikës Brenda Jugosllavisë nuk do të arin ta merr kurrë. Karakteristikë për të dy vendet ishte se ishin përfituese të fondeve të federatës për pjesët më pak të zhvilluara të Jugosllavisë ku Kosova kishte përfituar më shumë nga fondet nga shkak se kishte qenë një nga regjionet me të pa zhviluara. Ndërmjet viteve 1989 dhe 2008 kanë ndodhur shumë ngjarje në Kosovë, që do mund ti ndanim në tre periudha të mëdha dhe Ne e pranojmë këtë ndarje, por ne duhet të shtojmë edhe një periudhë tjetër - të tretë, përkatësisht periudhë pas vitit 2008, pra pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Periudha e parë përfshinë vitet midis 1989-1999, kjo është periudha pas heqjes së autonomisë së Kosovës, rezistenca paqësore, konflikti i armatosur si dhe bombardimet e NATO-s, krizën e refugjatëve dhe më në fund nënshkrimin e marrëveshjes së Kumanovës dhe Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Kosovën. Kjo periudhë është karakteristike se kemi vendosjen dhe kontrollin e gjithë aparatit shtetëror Serbë, ku në mënyrë sistematike kemi largimin e shqipëtarëve nga të gjitha institucionet dhe njëkohësisht kemi edhe krijimin e institucioneve paralele të shqipëtarëve. Periudha e dytë përfshin periudhën kohore nga viti 1998 deri në vitin 2008, periudhë e cila ka një ndryshim shumë të madhë ngaqë kemi largimin e aparatit represiv Serbë dhe kemi vendosjen e administratës së përkohëshme të OKB,

⁷¹ International Journal of Sciences: Basic and Applied Research (IJSBAR) (2013) Volume 12 The Relations between Macedonia and Kosovo, Dejan M, Elena I, Univerzitet Goce Delcev, v.2000.f.260-261

UNMIK. Me shpalljen e pavarësisë së Kosovës me 17 shkurt 2008 që edhe nënkupton edhe periudhën e tretë që fillon në vitin 2008 dhe zgjat deri në ditët e sotme. Siç cekëm edhe më lartë historiku I mardhënieve në mes Maqedonisë dhe Kosovës, daton që nga krijimi I ish Federatës Jugoslave, ku njëra ishte Republikë ndërsa tjetra kishte statusin e një Krahine Autonome, bashkëpunimi kryeshit ka qenë në aspektin regjional mare parasyshë afërsin. Aspekt tjetër I bashkëpunimit konsiston edhe me afërsin dhe mardhësniet të cilat I kan kultivuar shqiptarët e Maqedonisë me shqipëtarët e Kosovës në të gjitha sferat e jetës që ia imponon Maqedonisë kasrshi Kosovës të ketë një qasje më proactive dhe më positive. Mardheniet mes dy vendeve u intensifikuan si dhe mori një kahje ndyshe me ndërhyrjen e NATO-s dhe vendosjve e administrates së përkohëshme të OKB, UNMIK, ku Republika e Maqedonisë ishte nyja kyçe logjistike e këtyre organizmave ndërkombëtar, dhe do të vazhdoj të intensifikohet me pavarësimin e Kosovës si dy shtete të pavarua ku edhe do të kemi nënshkriminë marveshjeve bilateral që do ti thelonin dhe intensifikonin këta mardhënie.

4.2 Njohja e pavarësisë së Republikës së Kosovës nga Republikës së Maqedonisë

Republika e Kosovës pavarësin e vetë e shpalli, pas intervenimit të NATO-s, administrimit ndërkombëtarë nga OKB me misionin e saj UNMIK, pas bisedimeve të Vienës, dhe pas një periudhe kohore 10 vjeçare, me 17 shkurt 2008 e shpalli pavarësin e vetë. Sic edhe kemi cekur më lartë për shkak të kundërshimit të Rusisë dhe Kinës në Këshillin e Sigurimit, Republika e Kosovës, qasjen për njohje ndërkombëtare nuk e kishte realizuar si ish Republikat e tjera të ish Jugosllavisë, të cilat me antarsimin në OKB edhe kishin aritur njohjen ndërkombëtare. Republika e Kosovës njohjet e veta I ka aritur në komunikim të drejtpëdrejtë me shtetet. Para shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovë, qëndrimi I Republikës së Maqedonisë ishte se do të përkraj çdo marveshje që do të arinin Kosova dhe Serbia, dhe që do të mirahtoeshte në Kombet e Bashkuara dhe do të ndjek vendimet që do të marin SHBA, BE dhe NATO. Me shpalljen e pavarësisë Republika e Maqedonisë dëshmoi jovendosmëri dhe hamendje ku duhet të vendosnin të ruanin raportet dhe ti qëndronin pas Serbisë apo do ti bashkangjiten shteteve të BE dhe NATO-s, apo do të nxisin tensionet e bendëshme me popullatën Shqipëtare të Maqedonisë. Pas një perudhe me shum hamendje, presioni dhe lobimi nga vendet antare të BE dhe NATO dhe pas plotësimit të disa kushteve njohu pavarësinë e Kosovës⁷². Republika e Maqedonisë e kushtëzoi njohjen e pavarësisë së Kosovës me demarkimin e vijës kufitare mes dy vendeve prej 158 kilometrave në bazë të planit të Artisarit dhe me 9 tetor 2008 së bashku me Malin e Zi, njohu pavarësinë e Republikës së Kosovës ndërsa në vitin 2009 hapi edhe mbasadën e sajë në Prishtinë. Reagimi I Serbisë me rastin e njohjes së pavarësisë së Republikës së Kosovës nga Republika e Maqedonisë ishte shum I ashpër dhe I menjëhershëm duke

⁷² International Journal of Sciences: Basic and Applied Research (IJSBAR) (2013) Volume 12, The Relations between Macedonia and Kosovo, Dejan M, Elena I, Univerzitet Goce Delcev, v.2000.f.261-263

shpallur *PERSONA NON GRATA* ambasadorin e Maqedonisë në Beograd, dhe do të pasoj një periudhe e ftohjes së mardhënieve bilateral me Serbin.

4.3 Marëdhëniet bilateral Maqedoni – Kosovë

➤ **Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për Kushtet e Udhëtimit për shtetasit e dy vendeve.**

Marveshja u nënshkrua në Prishtinë me 8 shkurt 2016, në mes Ministrin të punëve të jashtëme të Republikës së Maqedonisë, Nikola Poposki dhe Zëvendës kryeministri dhe Ministër I punëve të jashtëme të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi. Pralamenti I Maqedonisë e ratifikoi më 22 shkurt 2016 ndërsa Parlamenti i Kosovës e ratifikaoi më 03 mars 2016, ndërsa ka hyrë në fuqi 17 prillë 2016. Harmonizimi I kësaj marveshje zgjati afër një vitë, kjo marveshje u ishte iniciuar nga pala kosovare në të njëjtën kohë ishte edhe kërkes e Bashkimit Evropiaan dhe Shteteve të Bashkuara të Ameriksë duke pasurë parasyshë se Republika e Maqedonisë kishte nënshkruar marveshje me gjithë shtetet fqinje aklimin e kufirit me letër njoftim ndërsa kishte ngleur vetëm me Republika e Kosovës pa u nënshkruar një marveshje e tillë. Gjithashtu edhe Republika e Kosovës të njëjtën marveshje e kishte nënshkruar me të gjithë shtetet fqinje përfshi edhe Republikën e Serbisë, kishte ngelur vetem me Republikën e Maqedonisë. Marvshja kishte për qëllim lehtësimin e lëvizjes së njerzive dhe mallrave mes dy vendeve gjithashu edhe me rajonin,

gjithashtu do të kontribojë në ritjen e këmbimit tregëtar. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje dy shtetet dëshpëruan se janë të interesuar për thellim të marrëdhënieve si dhe ndajnë vlera evropiane në këtë drejtim vlen të theksohet edhe koha e shkurtë e ratifikimit dhe e hyrjes në fuqi nga parlamentet përkatëse. Para nënshkrimit të kësaj marrëveshje dmth në fazën e harmonizimit, nga pala maqedonase kërkesat ishin që Republika e Kosovës, të lëshoj në qarkullim Letër njoftime Biometrike që nën kupton të ken instaluar një **çipë** të jenë lëshuar në qarkullim më shumë se 500.000 letër njoftime kërkes që e komplikonte edhe rjedhën e bisedimeve nga shkak se nëse arihet një marrëveshje e tillë të drejtë kalim të kufirit do të kishin të gjithë ata që janë të pajisur me letër njoftime biometrike. Ky kushtë I vënë nga pala maqedonase u tërhoq pas intervenimit të Bashkimit Evropian dhe faktorit politik shqipëtarë. Kjo marrëveshje në masë të madhe lehtësoi lëvizjen në veçanti në mes shqipëtarve të Maqedonisë dhe të Kosovës të cilët jetojnë nëpër fshatrat e brezit kufitarë. Edhe pse marrëveshja u nënshkrua dhe ratifikua në parlamentet të shteteve përkatëse për një afat kohor shumë të shkurtë, implementimi praktik hasi në pengesa e cila u menjanua me vullnetin e mirë të paleve kosovare dhe, gjatë harmonizimit të marrëveshjes palë ishin dakorduar që letër njoftimet të ashtuquajtura biometrike të ken instaluar çipë që mjeti përkatës të bëj leximin e të dhënave personale të shtetasëve. Pala Kosovare I kishte plotësuar të gjitha kushtet e parashtruar nga Republika e Maqedonisë por vetë nuk I ishte përmbajtur marrëveshjes në pjesë e letër njoftimeve biometrike qdmth, se letër njoftimet e Maqedonisë nuk janë biometrike dhe nuk kanë të instaluar Çip për leximin e të dhënave për shtetësit e Maqedonisë. Ministria e punëve të brendshme e Republikës së Kosovës e adresoi këtë çështje ku kërkesa ishte që marrëveshja të pushoj ose të shfuqizohet për kohësishtë deri sa Republika e Maqedonisë të filljë me lëshimin e letër njoftimeve biometrike të cilat do të ken të instaluar Çip për leximin e të dhënave. Institucionet e Republikës së Kosovës me qëllim që të mos jetë shkakëtar I cili pengon implementimin dhe zbatimin praktik dhe me qëllim që popullatën shqipëtare nga Maqedonisë dhe Kosova, most ë vendos edhe më the bariera për komunikim më të lehtë, vendosë që kjo marrëveshje të funksionoj kështu si është dhe me këta letër njoftime të cilat I ka në qarkullim Republika e Maqedonisë.

➤ **Marrëveshje mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për hapjen e pikës së re kufitare të përbashkët për udhëtim rrugor ndërkombëtar në mes dy vendeve "Stanciq - Belanocë".**

Kjo marrëveshje u nënshkruar më 24 qershor 2013 në kufirin kufitar Globoçicë, nga Ministrat e punëve të brendshme të Republikës së Maqedonisë dhe Kosovës, Gordana Jankulovksa dhe Bajram Rexhepi, ndërsa ka hyrë në fuqi në nëntor 2013. Kjo marrëveshje nënkupton hapjen e një pikë kalimi të ri kufitar mes dy shteteve i cili do të funksionoj si kalim i përbashkët ku oficerët policorë dhe të doganave të dy vendeve detyrat e tyre do të ushtronin në një ndërtesë të përbashkët, e cila duhet të ndërtohet në teritorin e dy

shteteve. Edhe kjo marveshje ishte e inicuar dhe në masë të madhe ishte e përkrahur edhe nga Bashkimi Evropian, ku edhe është finalizuar i ndërtimit të objektit të përbashkët kufitar me të vetmin qëllim afrimin edhe me të madhe dhe lëvizje të lirë mes qytetarëve të dy shteteve. Hapja e kalimit të përbashkët kufitar Stançiq-Bellanocë, ka për qëllim të lehtësoj qarkullimin e qytetarëve të dy vendeve të rajonit të Karadaku dhe Ana Moravës, qytetit të Kumanovës në Republikën e Maqedonisë dhe të Gjilanit e Kamnicës në Republikën e Kosovës. Ky kalim kufitar në bazë të marveshjes është parapar që të jetë kalim kufitar për transportë ndërkombëtar qdmt, se do lejohet qarkullim i mauneve me mallra dhe transport të qytetarëve nga vendete respektive. Në bazë të kësaj marveshje palët nënshkruesë obligohen që të formojnë një komision të përbashkët i cili do ta ramoniz dhe protokolin për hapjen e kalimit kufitar, projektin e godinës së përbashkët, si dhe marjen e lejes për ndërtim nga institucionet e shteteve përkatëse për ndërtim, duke pasur parasysh godina ndërtohet teritorine e dy shteteve. Marveshja parashikon gjithashtu që komisioni i përbashkët të ketë takime të rregullta një herë në dy muaj me qëllim që ta harmonizojnë protokolin dhe të pregaditin planin ideor për ndërtimin e hapësirave të objektit të kalimit kufitar, nga shkak se fondet për ndërtimin e godinës dhe hapësirave tjera përcjellese të kalimit kufitar do të finansonte bashkimi Evropian. Komisioni nuk ariti në kohë të përmbush obligimet që dalin nga marvesha, duke e prolonguar dhe tjezgjatur i gjith procesi i harmonizimit të protokolit për hapjen e kalimit kufitar. Komisioni detyrën e vetë e mabroi në vitin 2016 kur edhe u nënshkrua protokoli për hapjen e kalimit kufitar dhe gjithashtu parashifte që nga muaji prill 2017 të nisë edhe ndërtimi e godinës. Mirpo ngelën edhe një mori çështje të pa zgjidhura nga dy shtetet veçanti nga Republika e Maqedonisë, që kanë të bëjnë me ekspropriimin, fillimisht për hapësirën ku do të ndërtohet objekti dhe i rugës që çon deri te kalimi kufitar, asfaltimi, ryma elektrike si dhe marja e lejeve përkatëse nga institucionet përkatëse. Republika e Kosovës me nënshkrimin e marveshjes kishte marë hapa konkrete në këtë drejtim, për një kohë shumë të shkurt kishte kryer të gjitha obligimet që dalin nga kjo marveshje duke filluar me marjen e lejeve përkatëse për ndërtim, ekspropriimin e pronave për ndërtimin e rugës që çon deri te kalimi kufitar etj. Republika e Maqedonisë edhe pse kishte vullnet politik për hapjen e kalimit kufitar të përbashkët me Kosovën, nuk i ndërmori veprimet të cilat ishin paraparë me marveshje, nuk kishte marë lejet përkatëse nga institucionet për ndërtim nuk e kishte kryer procesin e ekspropriimit të pronave që kontribuonte edhe në prolongimin e fillimit të ndërtimit të godinës por edhe në funksionalizimin e kalimit kufitar.

➤ **Marrëveshje e bashkëpunimit në çështjet e integrimit në bashkëpunim evropian, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Maqedonisë.**

Marveshja u nënshkrua me 22. shkurt 2016, pas ratifikimit na parlamentet të vendeve përkatëse hyri në fuqi me 23 nëntor 2016. Koha e harmonizimit të kësaj marrëveshje ishte e shkurtë u nënshkrua me qëllim të këmbimit të përvojave në mes dy vendeve në rregull drejt antarsimit në Bashkimin Evropian, duke pasur parasysh se maqedonia ishte vend që kishte fituar edhe statusin e shtetit kandidat po ende pa marrë date për hapjen e bisedimeve dhe përvoja e Republikës së Maqedonisë për Republikën e Kosovës do ishte shumë domozdoshme. Kjo marrëveshje edhe pse kishte për qëllim thellim të bashkëpunimi dhe intensifikim të komunikimit mes dy shteteve në sferën e eurointegritimeve në praktik nuk i dha rezultatat e veta ishte mungesa e vullnetit politik dhe institucional, ngecja e Republikës së Maqedonisë në proceset integruese në Bashkimin Evropian, kjo marrëveshje ngeli vetëm në letër pas mos u funksionalizuar në praktik.

➤ **Marrëveshje për “Ekstradim”, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, e nënshkruar në Prishtinë me datë 8 prill 2011.**

Marveshja bilaterale ka për qëllim ekstradim të kërkuarve në shtetet respektive për vepra për të cilat ekziston vendim i plotë fuqishëm gjyqësor për të vuajtur dënimin ose për tu gjykuar. Me këtë marrëveshje shtetet respektive pajtohen që në bazë të procedurës të parapar në marrëveshje të kryhet e gjithë procedura e ekstradimit të personit të kërkuar ose tranzitimi nga vendet e treta. Kjo marrëveshje nga gjitha marrëveshjet në praktik funksionon më së miri dhe pa ndonjë pengesë të cfarëdo lloji natyre, ndërsa faktor kyç është koordinimi në mes Ministrive të drejtësis dhe të punëve të brendshme të shteteve përkatëse.

➤ **Marrëveshje për “Bashkëpunim Ekonomik”, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Kjo marrëveshje është nënshkruar në Shkup më 16 dhjetor 2009;**

Kjo marrëveshje kishte për qëllim thellimin e bashkëpunimit në ekonomi, këmbimin, tregëtar, investime në shtetet reciproke, investimet strategjike, pjesëmarrja në tregje të treta, investime të përbashkëta në infrastrukturë, energjetik, prodhimet bujqësore etj, eliminimin e barrierave tregëtare për mallrat që vin nga dy vendet. Me këtë marrëveshje parashitet formimi i Komitetit të përbashkët ekonomik në mes dy vendeve i cili obligohet të takohet dy herë në vitë dhe të diskutojnë dhe shqyrtojnë çështjet me interes të përbashkët kryesive për çështje ekonomike, pjesë e këtij komiteti nga dy palët janë Ministrat të cilët mbulojnë çështjet ekonomike të infrastrukturës, energjetikës të transportit si dhe dikastere të tjera në

bazë të nevojave të kohës. Edhe pse dy shtetet kanë marrë obligim me marrëveshje ndërkombëtare të formojnë komitet për zhvillim ekonomik si dhe të takohen dy herë në vitë, takimi i fundit i këtij komiteti ka qenë në vitin 2011 në Shkup, ka pasur disa kërkesa nga shtetet por që nga takimi i fundit komitetet nuk kanë mbajtur takime të përbashkëta. Mos funksionimi i këtij komiteti ose mos mbajtja e takimeve të rregullta kemi edhe ngecje në avancimin e projekteve të përbashkëta ekonomike, ngecje në këmbimin tregëtar si dhe lindin keqkuptimeve ose më së shumti marrëveshje të cilët sjellin edhe deri tek bllokada tregëtare, siç ishte në vitin 2013 dhe 2018 si masa të vëna nga Republika e Kosovës ndaj produkteve të prodhuara në Maqedoni.

- **Protokoll Bashkëpunimi për Themelimin dhe Funksionimin e Qendrës së Përbashkët të Kontaktit për Bashkëpunim Policor” ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Maqedonisë me 03 tetor 2011;**

Ky protokoll u nënshkrua me insistimin e Bashkimit Evropian, kjo qendër sipas protokollit selin do ta ketë në territorin e Republikës së Maqedonisë, dhe ka për qëllim këmbim të shpejtë informatave për shkelësit e ligjit, për personat e kërkuar nga dy shtetet. Kësi lloj zyre Republika e Kosovës ka hapur me gjithë shtetet që kufizohet, Republikën e Shqipërisë, Serbisë dhe Malin e Zi dhe më të gjithë funksionon. Edhe pse kjo zyrë ishte sponsoruar dhe inicuar nga Bashkimi Evropian, nga mos pasja e vullnetit politik nuk është funksionalizuar dhe nuk ushtron funksionin për të cilin është nënshkruar ky protokoll.

- **Memorandum i Bashkëpunimit në Fushën e Sigurisë” ndërmjet Ministrisë së Forcës dhe Sigurisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë. Nënshkruar në Prishtinë me 14 shkurt 2010.**

Kjo marrëveshje realizohet në përpikmëri, mes dy ministrive përkatëse ku parshifet edukimi i kadetëve nga Republika e Kosovës në Akademin Ushtarake Gjeneral Mihajlo Apostollski, për çdo vit akademik. Me këtë marrëveshje dy ministrinë janë dakorduar që në akademin ushtarake të Maqedonisë të edukohen kadetët nga Kosova të pakicave, Serbe, Malazeze, Boshnjake, marrë parasyshë afërsit gjuhësore. Që nga nënshkrimi i marrëveshjes në akademin ushtarake Gjeneral Mihajlo Apostollski, kanë mbaruar akademin ushtarake mbi 20 oficer të Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës, nga minoritetet.

KAPITULLI V

5.1 Konkluzionet

Republika e Maqedonisë dhe Republika e Kosovës në rugën e tyre drejtë pavarimit dhe konsolidimit shtetëror janë ballafaquar dhe vazhdojnë të ballafaqohen me sfida të ngajshme, siç janë integrimet euroatlantik, zgjidhja e çështjeve të hapura me fqinjët e tyre. Republika e Maqedonisë ariti të zghedhë çështjet e hapura me Republikën e Bullgarisë rreth dallimeve për gjuhën, kombin, historinë ndëra me Republikën e Greqisë u nënshkrua marrëveshja rreth kontestit me emrin e shtetit që ishte pengesë në rugën e Maqedonisë drejtë antarsimit në NATO dhe Bashkimin Evropian. Republika e Kosovës, gjat konsolidimit si shtet ishte e ballafaquar dhe vazhdon të ballafaqohet me sfida të cilat pengojnë integrimin dhe antarsimin në organizatat dërkombëtare multilaterale ku antare është Republika e Serbisë, gjithashtu pengesë për Kosovën është antarsimi në NATO dhe Bashkimin Evropian duke marrë parasysh se 5 vende antare të BE dhe NATO nuk kanë njohur pavarësinë e Kosovës dhe njëkohësisht paraqiten edhe si kundërshtar të Kosovës në të gjitha proceset e antarsimit në organizata multilaterale. Republika e Kosovës gjendet në një proces të vështirë bisedimesh me Republikën e Serbisë të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian për normalizimin e marrëdhënive si dhe aritjes së një marrëveshjeje që do të rezultonte me njohjen reciproke dhe njëkohësisht do të hapte rrugën për antarsime në organizatat dërkombëtare veçanërisht si fillim në OKB, dhe organizatat tjera. Dy shtetet, ishin paraqiturë para Gjykatës ndërkombëtare të drejtësisë, Maqedonia kishte paditur Greqinë, për shkeljen e Interim Accord, me rastin mos antarsimit të Maqedonisë në NATO në vitin 2008 në Bukureshtë, ku Greqia kishte vënë veto dhe rezultoi me mos antarsim të Maqedonisë. Interim Accord ishte marrëveshja e cila ishte aritur me Greqinë që rezultoi me antarsim në OKB të Maqedonisë, si dhe palët kishin rënë dakord që mos pengohet Maqedonia në antarsimin në organizatat ndërkombëtare përfshi edhe NATO dhe BE. Gjykata kishte vendosur në favor të Republikës së Maqedonisë dhe kishte konstatuar se Republika e Greqisë e kishte shkelur Interim Accord në rastin mos antarsimit të Maqedonisë në NATO. Republika e Kosovës, ishte paditur nga Republika e Serbisë, me arsyetimin se ishte shkelur e drejta ndërkombëtare me rastin shpalljes së pavarësisë si dhe nuk ishte respektuar rezoluta 1244 Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, gjykata kishte vendosur në favor të Republikës së Kosovës, dhe kishte konfirmuar se Kosova kishte shpallur pavarësinë në bazuar në të drejtën ndërkombëtare. Dy vendet që nga shpallja e pavarësisë së tyre sfidat kryesore kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë ekonomia e brishtë, mos funksionimi i shtetit ligjorë, tensionet e vazhdueshme, intra etnike dhe ndër etnike zhvillim i ulët ekonomik që kanë ndikuar dhe vazhdon të luajë një rol shumë të rëndësishëm në proceset integruese.

5.2 Rekomandimet

Republika e Maqedonisë dhe Republika e Kosovës në plan të brendshëm duhet të forcojnë funksionimin e shtetit ligjorë, forcimin e luftës kundër korupcionit dhe krimit të organizuar, veçanërisht luftimi i korupcionit në nivele të larta, pavarësim të gjyqësorit, reforma rënjësore në administratën shtetërore me qëllim të krijimit të një administrate profesionale si dhe njëkohësisht të zgjidhin çështjet e hapura me shtetet fqinje që është një dërr kushtet dhe kriteret e domozdoshme në rrugën drejt antarsimit në Bashkimin Evropian. Për Republikën e Maqedonisë nënshkrimi i marrëveshjeve me Republikën e Bullgarisë dhe Republikën e Greqisë, e sidomos me marrëveshja e ashtu quajture e Prespës, i hapë rrugë drejt stabilitetit politik dhe ekonomik, e cila në vetë paraqet një sfidë për vetë qeverinë e sidomos për popullatën maqedonase që të pranojë imponimin për ndryshimin e emrit kushtetues të shtetit. Republika e Maqedonisë duhet me çdo kushte të implementoj dy marrëveshjet me Bullgarinë dhe Greqinë, që ta qartësojë orientimin e vetë si shtet, a do të bashkohet familjes së shteteve Evropiane apo do të vazhdojë në kahjen drejt shteteve autokrate ku kemi shkelje të mëdha të drejtave të njeriut dhe kufizim të demokracisë. Pas implementimit të dy marrëveshjeve të lartë përmendura Republika e Maqedonisë duhet të përkushtohet edhe të drejtave të grupeve tjera etnika dhe përfshirje edhe më të mëdha institucionet dhe në vendimarrje njëkohësisht të kishen kushte për vendimarrje konsenzuale për çështjet strategjike dhe me interes të përgjithshëm, siç janë integrimi në NATO dhe BE, reformat në sistemin gjyqësorë, në strukturat e Ministrisë së Punëve të Brendshme, politikat sociale dhe arsimore ndarja proporcionale dhe rajonale e buxhetit si dhe investime në projekte strategjike siç janë në infrastrukturë, energjetik etj. Republika e Kosovës, për dallim nga Republika e Maqedonisë, çështje të hapura që duhet zgjidhur ka vetëm me Republikën e Serbisë. Marrëveshja historike e nënshkruar mes dy vendeve në vitin 2013, për normalizimin e marrëdhënieve pati disa zhvillime positive, u arritë integrimi i komunave të veriut të Kosovës me shumë serbe në administrimin dhe sistemin shtetëror, funksionalizimin e gjykatave në sistemin gjyqësor, kodi telefonik, funksionalizimi i sistemit doganor dhe policorë në Veri etj. Nga ky proces si çështje të cilat nuk janë zgjidhur dhe kushte që nuk janë plotësuar ka ngelur edhe themelimi i asociacionit të komunave me shumë serbe, kërkesa e cila është vështirë për tu realizuar nga shkak se Republika e Serbisë, kërkon që ky asociacion të ketë kompetenca ekzekutive, në sferën e arsimit, shëndetësisë, ekonomisë, resurseve natyrore siç janë minierat e trepçës, liqeni artificial i Ujmanit i cili e furnizon pjesën dërmuese të Kosovës me ujë, planifikimit urban etj. Për këtë çështje nxori një vendim Gjykata kushtetuese e Republikës së Kosovës e cila sugjeron një asociacion i komunave serbe me kompetenca ekzekutive është në kundërshtim me kushtetutën dhe ligjet e shtetit të Kosovës, dhe njëherit sugjeron që gjatë vazhdimit të mëtejshëm të procedurave për themelimit të këtij asociacioni të respektohet dhe most të shkellet kushtetuta e vendit. Republika e Kosovës, në rrugën e vetë drejt antarsimit në Bashkimin Evropian, duhet të ngrahohet më

shumënë luftën kundër korupcionit në nivele të larta të aparatit shtetëror, pavarësi I gjyqësorit nga ndikimi politik, luftë kundër krimit të organizuar, administratë publike me efikasitet si dhe zhvillim ekonomik, që një herit janë edhe si kushte për liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës në zonën SHENGEN. Në planin bilateral dy shtetet duhet të angazhohen më shumë në përafrimin e procedurave dhe ligjeve sidomos në sistemin doganorë, që do të mundësonin rritjen e këmbimit tregëtar si dhe eliminimin e barrierave të ndryshme që praqiten si pengesë si psh, krijimin e në terminali të përbashkët doganorë ku doganat e dy shteteve do të bënin zhdoganimin ku do të kursente kohë dhe shpenzime shtesë dhe të pa nevojshme. Krijimin e pikave të përbashkëta kontrollit policorë në kalimet kufitare psh, gjat hyrjes në Republikën e Maqedonisë, kontrollat do të kryente vetëm policia e Maqedonisë dhe anasjelltas gjat hyrjes në Republikën e Kosovës, kontrollet të ushtrisë veteë policia e Kosovës. Në këtë mënyrë do të lehtësohet në masë të madhe lëvizja e lire e qytetarëve nga dy anët e kufirit dhe do të evitohen pritjet e gjata dhe kontrollet e dyfishta, hapja e kalimeve të reja kufitare të përbashkëta si ai Belanocë-Stançiq, hapje edhe të kalimeve tjera kufitare që lidhe Prizrenin me Tetovën, funksionalizimi I kalimit të përbashkët kufitar hekurudhor, projekte të përbashkëta në Energjetik duke pasurë parasysh se dy vendet paguajnë kosto shumë të lartë nga importi I energjisë elektrike. Dy vendet duhet ti shqyrtojnë mundësitë e bashkëpunimit në hapjen e përfaqësive të përbashkëta diplomatike, aktualishtë Republika e Kosovës ka të hapura përfaqësi diplomatike me Republikën e Shqipërisë, ndërsa Republika e Maqedonisë më Malin e Zi.

5.3 Përfundimi

Nga i gjithë ky hulumtim arrijë në përfundim se ruga e etablimit si shtetete njohja ndërkombëtare integrimet në organizatat ndërkombëtare multilaterale, siç janë Organizata e Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe NATO, ka qenë shumë e vështirë dhe me plotë sfida. Dy vendet u krijuan si shtete si rezultat i shpërbërjes së ish shtetit të përbashkët Republika Socialiste Federative të Jugosllavisë, dy shtetet kishin status të ndryshëm juridiko kushtetues, Maqedonia ishte si Republikë ndërsa Kosova ishte si krahinë autonome. Për dy vendet ngelin sfidat për forcimin e shtetit ligjor dhe forcimit të institucioneve, zgjidhje të çështjeve të hapura me shtetet fqinje që do të lehtësonin rrugën drejtë antarimit në organizatat ndërkombëtare dhe do të siguronin stabilitet më të madhë rajonit të Evropës Juglindore. Shtetet mes veti me anë të marrëdhënieve bilateral kanë për qëllim të përmisojnë dhe të avansojnë marrëdhëniet në sferën e caktuar. Republika e Maqedonisë edhe Republika e Kosovës, në mënyrë që të lehtësojnë komunikimin dhe të avansojnë marrëdhëniet mes veti kanë nën shkruar me shumë se 32 marrëveshje

bilateral në shumë, në sferën e tregëtis, energjetikës, punëve të brendëshme, ambientit, pushtetit local, arsimit etj. Të gjitha këta marrëveshje në vetë kanë edhe sfidat e tyre gjatë nënshkrimit e sidomos në implementimin e tyre, andaj nga dy qeverit e dy shteteve do duhet angazhim edhe me I madhe që të eliminohen të gjitha barrierat që qytetarët e dy shteteve lirshëm dhe pa pengesa të zhvilliojnë aktivitetet e tyre në shtetet nënshkruar të marrëveshjeve. Gjatë elaborimit të temës do të analizohen më detajisht pengesat dhe barrierat që janë paraqitur mes dy shteteve, gjatë implementimit të marrëveshjeve të nënshkruara bilateral mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës.

5.4 Bibliografia

1. Diplomatic Handbook R.G Faltham fifth edition, Oxford Univesitz pres, 1988
2. Selected National Euripian an international Provisions form Public anda Private Law, Philip Kiiver & Nicole Cornet, Europa Laë Publishing, Groningen 2008.
3. Fundamentals of International Business Transactions Documents, Ronald A Brand, Kluëer Laë International.
4. Od Objekt do Subjekt- Makedonija vo Megunarodnite odnosi, Viktor Gaber, Fridrich ebert, Stiftung, Skopje 2017.
5. Manual Diplomatik, Yejnula Gruda, Prishtine 2009 Megunarodno Javno Pravo, L.D. Frckovski, V. Tuprkovski, V Ortakovski, Tebarnakul 1995.
6. Slucaj i Materijali od megunarodno pravo, Martin Dikson, Robert Mekorkuoel.
7. Megunarodno Javno Pravo Davide Ruyie, Skopje 2006.
8. Antu – Discrimination Laë and European Union, Mark Bell, Oxford Universitz press.
9. Evropsko Parvo, Yan Klod Gorton, Skopje 2006- prvo izdanie.
10. Hyrje në Mbrojtjen Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, Botimi Dytë, Raija Hanski dhe Markku Suksi, Instituti për të Drejtat e Njeriut, Univerziteti i Abo Akademisë, 1999.
11. Përmbledhje instrumenteve ndërkombëtare, vëllimi i parë, Instrumentet e Përgjithëshme, Qendra për të drjetat e Njeriut Gjenevem, Kombet e Bashkuara, Neë York dhe Gjeneve 1994.
12. Pravo na Evropskata Unijaa i Zaednickite politki, Pjer Le Mir, Skopje 2006, prvo iydanie, profesor na Univeryitetot Pangon- Sorbona Pariy 1.
13. Ë drejtat e njeriut vlerë demokratike, Fridrich Ebert Stiftung, Milinka Trajkovska.
14. Pravo na Evropska Unija, Univeryitet Sv Kiril i Metodij , SkopjePraven Fakultet, Trajan Bendeovski, Skopje 2001.
15. Pravo na Evropskata konvencija ya covekovite prava, DJ haryi, MO Vojl, EP Bejts SM Bakli, vtoro iydanie, prosvetno delo 2009.
16. Evropsko Parvo za covekovi prava, Mjanis, P.Kej A.Bredli.
17. E drejta ndërkombëtare, Malkom Sho, Botimi i 6, Prosvetno Delo 2009;
18. Политикологија, Димитар Бајалциев, Правен Факултет, Скопје “Македонска Ризница”, Куманово, 2000 г.
19. Вовед во правото на државата, Димитар Бајалциев Прва Книга Европа 92, 1999 г.
20. Т.Бендевски, Правото на Европска Унија, УКИМ, Правен Факултет, Скопје 2001 г.

21. Јанчева Љ, Последните децении со СФРЈ, Менора, Скопје, 2012.
22. Андов С., На мој начин, Матица Македонска, Скопје 2003.
23. Велјановски Н., Македонија 1945-1991 државност и независност, Институт за национална историја, Скопје 2002.
24. Кљусев Н, Патот кон македонската независност, Матица Македонска, Скопје 2001
25. Малески Д, Бебето од катран – Македонија во меѓународните односи (1991-1993), Култура, Скопје 2012.
26. Тунтев А., Република Македонија – прва декада (1990-1999), Ми-Ан, Скопје 2005.
27. Декларација за прогласување на независноста на Република Македонија број 08-3786 од 17.09.1991.
28. Георгиевски С и Додевски С, Документи за Република Македонија 1990-2005, Правен Факултет „Јустинијан Први“, Скопје 2008.
29. Шкарик С, Македонија на сите континенти, Унион Трејд, Скопје 2000.
30. Георгиевски С. и Додевски С., Документи за Република Македонија 1990-2005, Правен Факултет „Јустинијан Први“, Скопје 2008.
31. Декларација за меѓународно признавање на Република Македонија како суверена и независна држава број 08-5099 од 15.12.1991.
32. Љ.Д.Фрчкоски, В.Тупркоски, В.Ортакоски, Меѓународно јавно право, Табернакул, 1995.
33. Ligji mbi ratifikimin e marveshjes se prkoheshme ne mes Republikes se Greqies dhe Republikes se Maqedonise, nenshkruar me 13 shtator 1995 ne Njujork nr 08-3396/1 nga 09.10.1995
34. [://mfa.gov.mk/images/stories/Dokumenti/Vremena-spogodba-1995.pdf](http://mfa.gov.mk/images/stories/Dokumenti/Vremena-spogodba-1995.pdf)
35. Влада на Република Македонија -Секретаријат за спроведување на Охридски рамковен договор- Извештај по однос на состојбата за имплементација на сите политики што произлегуваат од Охридскиот рамковен договор – Скопје 2012.
36. Указ за прогласување на Законот за рафтификација на спогодбата за стабилизација и асоцијација меѓу Република Македонија и Европските заедници и нејзините членки 07-1432/1 од 12.04.2001 година.
37. Клучни Елементи на Република Македонија против Грција Пресуда на Меѓународниот суд на правдата од 05 декември 2011 година.
<http://mfa.gov.mk/images/stories/Dokumenti/Summary-ICJ-MKD.pdf>
38. http://www.siofa.gov.mk/data/file/Ramkoven_dogovor_al.pdf,
http://www.siofa.gov.mk/data/file/ustav_ustavni_amandmani_al.pdf
39. В.Габер Од објект до субјект, Македонија во меѓународните односи, Fridrich Ebert Stiftung, Скопје 2017.

40. Т.Бендевски, Право на Европска Унија, УКИМ, Правен Факултер, Скопје 2001.
41. <http://mfa.gov.mk/images/stories/Dokumenti/Summary-ICJ-MKD.pdf>
42. http://mfa.gov.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=112&Itemid=391&lang=mk
43. http://mfa.gov.mk/images/stories/Dokumenti/konechna_spogodba_makedonija_greija.pdf
44. Shklzen Gashi Historia e Kosovës në tekstet mësimore të histories në Kosovë, Shqipëri, Mal të Zi dhe Maqedoni, alter habitus, instituti për studime në shoqëri dhe kulturë, Prishtinë 2016.
45. Dr. Jakup Krasniqi: Pavarësi dhe personalitete, Buzuku, Prishtinë 2012, f. 22.
46. Rilindja”, 22.1.1989, Prishtinë.
47. M.Dikson dhe R.Mekorkuoel, Raste dhe Materijale nga e Drejta Ndërkombëtare, Shkup, 2010.
48. Dokumenti Përfundimtar i Rambujesë.
49. Marrëveshja për Demilitarizimin e UÇK-së mes Hashim Thaçit dhe Komandantit të KFOR-it, Gjeneral Xheksonit, 21 qershor 1999, në Aeroportin e Sllatinës.
50. Parimet udhëheqëse te Grupit të kontaktit për zgjidhjen e statusit të Kosovës, 7 tetor 2005. (http://www.unosek.org/docref/2005-10-07_-_Contact_Group_-_Ten_Guiding_principles_for_Ahtissari_-_albanian.pdf).
51. Mati Ahtisari: Propozimi për Presidentin e KS dhe Sekretarin e Përgjithshëm në OKB-së i 26 marsit 2007, dokumenti S/2007/168.
52. Bejtush Gashi & Xhelal Jusufi, 2013, “Sistemi i Menaxhimit të Krizave”, fq. 297. 95 Line King dhe Ëhit Mason, 2007, “Paqe me Çdo Kusht-Si dështoi bota në Kosovë”, Prishtinë, fq. 272, Raporti i OSBE-së, 1999.
53. Plani Gjashtë Pikësh të Ban Ki-Moon, sekretari general I OKB.
54. R.G Feltham, Diplomatic Handbook, Fifth edition, Longman Groupn UK Limited, 1988,f 62-72
55. Kosovo in the Internatioanl court of Justice, faqe 11,
56. www.mfa-ks.net/assets/cms/uploads/files/Burime/Kosovo%20in%20the%20International%20Court%20of%20Justice/kosova-ne-gjykaten-nderkombetare-te-drejtise.pdf
57. Kosovo in the Internatioanl court of Justice, faqe 13.
58. www.mfaks.net/assets/cms/uploads/files/Burime/Kosovo%20in%20the%20International%20Court%20of%20Justice/kosova-ne-gjykaten-nderkombetare-te-drejtise.pdf
59. Dokumenti Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit Përfundimtar të Kosovës.
60. Bujar Desku “Interpretimi i Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës nga GJND, Shtëpia Botuese Faik Konica, 2013.

61. Reformat e Administratës publike në Republikën e Maqedonisë drejt Integritimit Evropian”, Abdulla A, 2008, Tetovë.
62. Integrimi i Kosovës në Bashkimin Evropian, Prof.Dr.Armand Krasniqi Msc.Cand.Visare Ndreca,
63. Plani Kombëtar Zhvillimor i Kosoves 2007 – 2013- Strategjia Sektoriale per Integrim Evropian, Qeveria e Kosoves 2007.
64. Mirishahe S, Kosova perballë 5 vendete antare të BE që nuk e kan njohur pavarishtë, KIPRED, Instituti Kosovarë për kërkime dhe zhvillim të politikave, Prishtinë 2013.
65. Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia për aritjen e njohjes së plotë ndërkombëtare, Qershor 2011, f.3
66. International Journal of Sciences: Basic and Applied Research (IJSBAR) (2013) Volume 12 The Relations between Macedonia and Kosovo, Dejan M, Elena I, Univerzitet Goce Delcev.
67. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 157/2010.
68. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 66/2010.
69. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.77/2010
70. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 170/2010
71. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 157/2010.
72. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.10/2012
73. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 178/2011
74. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.25/2012
75. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 92/2013
76. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.150/2013
77. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.215/02015
78. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.6/2016
79. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.38/2016
80. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 191/2016
81. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.52/2018
82. Hyrje në Mbrojtjen Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, botimi dytë, R.Hanskin&M.Suksi- Instituti për të Drejtat e Njeriut, Univerziteti I Abo Akademisë, 1999.